


Hartëzimi i programeve të rehabilitimit dhe riintegritimit (R&R) për personat e kthyer nga zonat e konfliktit



Hartëzimi i programeve të rehabilitimit dhe riintegritimit (R&R) për personat e kthyer nga zonat e konfliktit



Përgatitur nga:

Prof. As. Dr. Rudina Rama
PhD. C. Armela Xhaho

Tiranë, 2022

Ky modul u hartua në kuadër të Programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve si dhe me Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, koordinuar në nivel kombëtar nga Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me financim të Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

Pikëpamjet dhe informacionet e dhëna në këtë dokument janë vetëm të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e donatorit.



Përmbajtja

Përkufizimi i termave	5
Pjesa. I. Hyrje	9
1.1 Programet e Rehabilitimit dhe Riintegritimit (R&R) për personat e kthyer nga zonat e konfliktit	9
PJESA 2. Profili i grave dhe fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit	12
2.1 Panoramë e përgjithshme e personave të kthyer nga zonat e konfliktit dhe qasja institucionale	12
2.2 Gratë dhe fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit si grupe të rrezikuara në nevojë	16
2.3 Profili i grave dhe fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit	17
PJESA 3. Qasja e integruar dhe multidisiplinare në ofrimin e programeve R&R	20
3.1 Parimet për ofrimin e programeve R&R	20
3.2 Qasja multi-aktoriale në programet R&R për personat e kthyer nga zonat e konfliktit	22
3.3 Qasja e përshtatur sipas nevojave	23
PJESA 4. Raste Studimore për zbatimin e programeve R&R	32
4.1 Rasti i Danimarkës - Modeli Aarhus	32
4.2 Rasti i Gjermanisë: Hayat (OJQ si pjesë e një partneriteti publik-privat)	33
4.3 Rasti i Kosovës	34
4.4 Rasti i Shqipërisë	35
4.5 Rasti i Finlandes	38
PJESA 5. Hartëzimi i Programeve R&R	42
5.1 Arsimimi	43
5.2 Mbështetja shëndetësore	49
5.3 Mbështetja psiko-sociale	58
5.4 Strehimi	74
5.5 Punësimi dhe formimi profesional	82
5.6 Mbështetja ligjore falas	94

Përkufizimi i termave

Ekstremizmi i dhunshëm (EDH) - është procesi i adoptimit të pikëpamjeve radikale (politike, ideologjike ose fetare) dhe kthimit të tyre në veprime të dhunshme. EDH është faza përfundimtare e procesit të radikalizimit dhe i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të arritur objektivat politike, fetare ose ideologjike. Ekstremistë të dhunshëm nuk janë vetëm individët që janë të gatshëm të përdorin dhunë fizike, por edhe ata që mbështesin, rekrutojnë ose punojnë në mënyrë aktive në favor të një ideologjie ekstremiste të dhunshme.

Radikalizim - është procesi i zhvillimit të ideologjive dhe pikëpamjeve ekstremiste. Radikalizimi mund të jetë i dhunshëm ose jo.

Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm (LKEDH) nënkupton nisma dhe strategji që përqendrohen te lufta kundër procesit të radikalizimit dhe te frenimi i rekrutimit të ekstremistëve të dhunshëm. Është një reagim gjithëpërfshirës që synon mobilizimin dhe fuqizimin e aktorëve të ndryshëm si, për shembull, institucionet e sigurisë, pushtetin vendor, arsimtarët, punonjësit socialë, komunitetin fetar dhe shoqërinë civile, me qëllim promovimin e vlerave qytetare dhe respektimin e të drejtave të njeriut. LKEDH-ja trajton edhe “kushtet që favorizojnë” përhapjen e EDH-së dhe terrorizmit duke marrë parasysh dhe duke ndihmuar në zbutjen e zemërimit, që mund të shfrytëzohet nga ekstremistët dhe mbështetësit e tyre.

Luftëtarë të huaj terroristë (LHT) janë individë që udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen dhe/ose pjesëmarrjen në akte terroriste apo ofrimin dhe/ose marrjen e trajnimit terrorist, qoftë ai edhe për një konflikt të armatosur.

Deradikalizimi është një proces që kryhet kryesisht përmes një sistemi programesh dhe masash që synojnë uljen e nivelit të radikalizimit të pikëpamjeve ideologjike dhe riintegrimin në shoqëri të individëve të radikalizuar. Ky proces mbështetet te supozimi se jo të gjithë personat që radikalizohen i qëndrojnë përherë besnikë kauzës së tyre. Programet

e deradikalizimit, në praktikë, kanë si objektiv individët e radikalizuar në të gjitha fazat e ciklit të ekstremizmit, përfshirë këtu periudhën para se të bëhen pjesë e një grupi apo rrjeti ekstremist, si anëtarë aktivë apo të larguar/shkëputur. Ky proces mund të ketë si qëllim të frenojë përfshirjen e tyre në akte dhune (deradikalizimi i sjelljes), apo ndryshimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve të tyre ideologjike (deradikalizimi i mendimeve).

Shkëputja nga ekstremizmi i dhunshëm i referohet procesit të rikthimit nëpërmjet të cilit një individ nxitet të heqë dorë nga normat, vlerat, qëndrimet dhe aspiratat e përbashkëta me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Shkëputja mund të jetë fizike, që nënkupton largimin fizik të individit nga grupi, dhe/ose psikologjike, që nënkupton shkëputjen e individit nga mendimi për përfshirje në aktivitetet e grupit ekstremist. Shkëputja nuk do të thotë domosdoshmërisht që një person ka ndryshuar ideologjikisht bindjet e tij. Në fakt, sjellja e tij e largon këtë individ nga rrethanat që e lidhnin atë me grupin e tij të mëparshëm.

Programet e rehabilitimit dhe riintegrit (R&R) janë programe që kanë në fokus të punës së tyre individë të radikalizuar për akte të dhunshme (dhe jo vetëm), përfshirë këtu edhe ata individë që kanë kryer vepra që lidhen me terrorizmin dhe me raste edhe familjet e tyre si dhe ata që nuk vuajnë dënime në burg, por që mund të shfaqin mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm, përfshirë edhe individët e kthyer nga Siria dhe Iraku. Programet R&R veprojnë në institucionet e riedukimit, në komunitete, ose si pjesë e shërbimit të provës. Në këto programe mund të ofrohen mësim, trajnime profesionale, këshillim, mundësi punësimi dhe riedukim ideologjik. Nga ana tjetër, rehabilitimi dhe riintegrimi në komunitet nënkupton një sërë nismash që u bëjnë të mundur individëve të kthyer të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi me anëtarët e tjerë të komunitetit si, për shembull, shërbime shëndetësore, arsimim, formim profesional, punësim, përfshirje në vendimmarrjen vendore, etj.

Rehabilitimi është faza kur personat përgjegjës ndërmarrin veprime për të trajtuar sjelljen dhe aftësitë njohëse të të kthyerve si dhe organizojnë aktivitete përgatitore për të përforcuar qëndresën personale të individit ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe për t'i përgatitur ata për riintegrimin në shoqëri. Kjo mund të ndodhë pas fazës së shkëputjes dhe/ose deradikalizimit, por mund të ndodhë edhe në të njëjtën kohë me këto procese. Në kontekstin e luftës kundër EDH, rehabilitimi përqendrohet veçanërisht në rezistencën ndaj angazhimit në ekstremizëm të dhunshëm, duke synuar që individit të mos i rikthehet grupit të mëparshëm por të jetë gati për riintegrim funksional shoqëror dhe largimin nga sjellja kriminale.

Riintegrimi është faza ku punonjësit ndihmojnë kalimin e individit të rehabilituar përsëri në “kushtet e dëshiruara” në shoqërinë normale. Në të njëjtën kohë, punonjësit duhet të punojnë edhe me komunitetin e caktuar ku do të banojë përfundimisht individi në fjalë, për të zbutur stigmën sociale dhe për të bërë të mundur që ky individ të pranohet në shoqëri. Po ashtu, duhet theksuar se në disa raste, kjo fazë në fakt mund të konsiderohet më shumë si “integrim” sesa “riintegrim”, për shkak të rrethanave të mëparshme shoqërore të individit që kanë penguar integrimin që në fillim. Megjithatë, në këtë udhëzues do të përdoret termi “riintegrim” meqenëse ky term pranohet gjerësisht.

Qasja e integruar – një qasje planifikimi që ndërthur çështjet nga të gjithë sektorët, institucionet në nivele kombëtare dhe vendore si dhe grupet e ndryshme të popullsisë.

SHKURTESA

EDH	Ekstremizmi i dhunshëm
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
KVSP	Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike
LHT	Luftëtarë të huaj terroristë
LKEDH	Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm
OJQ	Organizatat joqeveritare
PMF	Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës
R&R	Rehabilitimi dhe riintegrimi
PIV	Plani Individual i Veprimit
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë

Pjesa I. Hyrje

1.1 Programet e Rehabilitimit dhe Riintegrimin (R&R) për personat e kthyer nga zonat e konfliktit

Ofrimi i programeve të rehabilitimit dhe riintegrimin për personat e kthyer nga zonat e konfliktit është një proces i ndërlikuar, dinamik dhe shumë-dimensional i cili kërkon një qasje gjithëpërfshirëse. Ndonëse deri më tani nuk ka një model të unifikuar dhe koherent të ofrimit të programeve R&R për kategorinë e personave që kthehen nga zonat e konfliktit, mbështetja e ofruar shkon përtej përgjigjes humanitare për plotësimin e nevojave më emergjente dhe bazike. Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i programeve R&R duhet të marrë në konsideratë bashkërendimin e ndërhyrjes shumë-aktoriale duke adresuar nevojat e veçanta personale dhe familjare të të kthyerve. Programet R&R mund të ofrojnë ndër të tjera, arsimim dhe trajnim profesional, mundësi punësimi, këshillim fetar, psikologjik apo familjar, trajnim profesional dhe punësim, veprimtari kulturore dhe zbavitëse.

Një ndërhyrje e tillë ka për qëllim përmirësimin e gjendjes mendore, risocializimin dhe riintegrimin e personave në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Ndonëse kuadri ligjor në Shqipëri nuk e përcakton në mënyrë qartë nëse personat e kthyer nga zonat e konfliktit, dhe në veçanti gratë dhe fëmijët, janë pjesë e grupeve të cënueshme¹, vulnerabiliteti i tyre i shumëfishtë për shkak të traumave të përjetuara gjatë luftës, dëmtimeve fizike, vështirësive për t'u përshtatur i bën këto grupe më të rrezikuara dhe në nevojë për përkrahje dhe programe të veçanta R&R. Për këtë arsye, është e rëndësishme që punonjësit e vijës së parë të jenë sa më vigjilentë dhe të përgatitur gjatë procesit të identifikimit të nevojave shëndetësore, arsimore, psikologjike dhe sociale të tyre. Institucionet përkatëse duhet të garantojnë marrjen e shërbimeve të përshtatshme sipas moshës dhe gjinisë.

Përfshirja e të kthyerve nga zonat e konfliktit në programet R&R ka për qëllim:

- T'i ndihmojë individët të përshtaten me realitetin e tyre të ri përmes riaftësimin social;
- T'i ndihmojë të kthyerit të tejkalojnë sfidat dhe traumat emocionale;

1 Gruset e cënueshme janë persona të cilët për shkak të karakteristikave të tyre apo kushteve të pafavorshme kanë nevojë për mbështetje dhe masa të veçanta riintegrimi.

- Të rrisë qëndresën komunitare dhe të sigurojë mundësi që personat e kthyer të angazhohen në mënyrë pozitive me komunitetin;
- T’ju mundësojë personave të jenë sa më të pavarur në komunitetin ku ata kthehen, përmes riintegrit të suksesshëm në jetën shoqërore, sistemin arsimor dhe tregun e punës;
- Të përforcojë qëndresën personale të individëve të kthyer ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Qasjet efektive të riintegrit kërkojnë angazhim dhe punë me komunitetet, institucionet vendore dhe qendrore, punonjësit e vijës së parë, me individët dhe familjet e të kthyerve, si dhe me personat që priren të ndikohen nga ideologjitë ekstremiste. Programet efektive të rehabilitimit dhe riintegrit janë të rëndësishme jo vetëm për parandalimin e veprimeve të dhunshme në të ardhmen, por edhe për menaxhimin e radikalizimit të mëtejshëm (veçanërisht mes të rinjve), si dhe për forcimin e qëndresës së komunitetit ndaj EDH.²

Ky modul është hartuar për t’i ardhur në ndihmë punonjësve të vijës së parë, zyrtarëve të njësive të vetëqeverisjes vendore, punonjësve socialë, psikologëve, profesionistëve të shëndetit, mësuesve dhe policisë, të cilët duhet të lehtësojnë aksesin në shërbime për personat e kthyer nga zonat e konfliktit. Praktika e deritanishme ka treguar se bashkëpunimi shumëaktorial siguron vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve R&R.

Ky modul trajnimi synon të informojë punonjësit e vijës së parë mbi llojet e programeve R&R dhe qasjen e të kthyerve në këto programe. Moduli udhëzon hap pas hapi ndërhyrjet të cilat orientojnë punën e punonjësve të vijës së parë gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve. Këto programe përfshijnë aksesin në të drejtat dhe shërbime të organizuara sipas fushave të mëposhtme të ndërhyrjes:

- 1.** Ligjore (regjistrimi në gjendjen civile, shtetësia, dokumentet);
- 2.** Social-ekonomike (strehimi, punësimi, formimi profesional, kujdesi shëndetësor, ndihma psiko-sociale);
- 3.** Kohezioni social (arsimi, mësimi i gjuhës dhe orientimi shoqëror, nxitja e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në komunitet).

2 Holmer, G. dhe Shtuni, A. (2017). Returning Foreign Fighters and the Reintegration Imperative. United States Institute of Peace. Washington, DC

Moduli është i strukturuar në pesë pjesë kryesore:

1. Pjesa e parë e modulit ofron një panoramë të përgjithshme të EDH në Shqipëri, duke u fokusuar në rëndësinë e programeve R&R për personat e kthyer nga zonat e konfliktit.
2. Pjesa e dytë e modulit hedh dritë mbi profilin e grave dhe fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit si grupe të cenueshme me nevoja të veçanta.
3. Në kapitullin në vijim përshkruhen parimet e përgjithshme për ofrimin e programeve R&R dhe rëndësia e qasjes së integruar multidisiplinare dhe shumëaktoriale.
4. Në kreun e katërt përshkruhen disa raste dhe praktika pozitive të programeve R&R në shtete të ndryshme.
5. Pjesa e fundit hartëzon programet R&R sipas fushave dhe nënfushave kryesore të ndërhyrjes. Plani i ndërhyrjes jep një përshkrim të shkurtër të shërbimit duke u fokusuar te nevojat e grupit në fjalë, kuadri ligjor dhe nënligjor, fusha e veprimit, institucionet dhe personat përgjegjës si dhe hapat dhe procedurat që duhet të ndiqen për të marrë shërbimin.

PJESA 2. Profili i grave dhe fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit

2.1 Panoramë e përgjithshme e personave të kthyer nga zonat e konfliktit dhe qasja institucionale


Shqipëria renditet në vendin e tretë në Ballkanin Perëndimor për numrin më të lartë të shtetasve të larguar drejt Sirisë dhe Irakut në raport me numrin e popullsisë. Sipas të dhënave zyrtare, përlllogaritet se rreth 144 shtetas shqiptarë (38 fëmijë, 27 gra dhe 79 burra) iu bashkuan konfliktit në Irak dhe Siri gjatë viteve 2012-2015.³ Pasi u përball me një largim të konsiderueshëm të shtetasve drejt zonave të konfliktit dhe më pas me kthimin e tyre vullnetar në Shqipëri deri në vitin 2014, qeveria shqiptare reagoi nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal, rritjes së kapaciteteve të forcave të rendit, ngritjes së Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe miratimit të një strategji kombëtare për këtë çështje⁴. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, Qeveria shqiptare ka riatdhesuar nga kampi Al-Hawl në Siri, 37 shtetas shqiptarë.⁵

3 GCERF. (2020). Rehabilitation and Reintegration of Returning Foreign Terrorist Fighters (RFTFs) and Their Families in the Western Balkans. Regional Needs Assessment. 2020; VKM 1137/2020, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Luftën kundër Terrorizmit", 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023.

4 Qirjazi, R. dhe Shehu, R. (2018). Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri. Raport studimor, Berlin: Berghof Foundation.

5 VKM 826/2020. "Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku".

Figura 1. Numri i shtetasve shqiptarë të riatdhesuar



Burimi i informacionit⁶

Megjithatë, numri total i të kthyerve është më i lartë, nëse marrim parasysh edhe kthimet vullnetare të 45 shtetasve shqiptarë përpara miratimit të ligjit në vitin 2014 që e konsideron si vepër penale pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura në shtetet e huaja.⁷ Hulumtimet kanë treguar se faktorët që kontribuojnë në radikalizim dhe EDH kanë bazë ideologjike, socio-ekonomike dhe strukturore. Ato janë zakonisht një kombinim i kohezionit të dobët shoqëror (komunitetet), qeverisjes joefektive (institucionet), dhe besimeve dhe sjelljeve ekstremiste personale (ideologjia).⁸

6 Halluni, 1. (2020). Mbërrijnë në Shqipëri 4 fëmijë dhe 1 grua nga kampi famëkeq i Sirisë, Al Howl TRT: E disponueshme në <https://bit.ly/3a16axZ>; Euronews Albania . (2021). Pesë gra dhe 14 fëmijë riatdhesohen nga kampet e ISIS në Siri, Rama: Operacioni, i rrezikshëm. E disponueshme në <https://bit.ly/3AbzNau>; Nga kampi Al Hawl drejt Shqipërisë edhe 13 persona të tjerë. E disponueshme në <https://bit.ly/39Vi2kY>

7 Rehabilitation and Reintegration of Returning Foreign Terrorist Fighters (RFTFs) and Their Families in the Western Balkans. Regional Needs Assessment. 2020.

8 Qirjazi dhe Shehu, 2018

Figura. 2 Faktorët që kontribuojnë në radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm

Faktorët e përgjithshëm shtytës:

- Papunësia
- Mungesa e qasjes në arsim
- Margjinalizimi etnik

Genueshmëritë individuale:

- Zemërimi për shkak të papunësisë
- Mungesa e identitetit personal
- Shkëputja nga shteti/familja
- Ekspozimi ndaj grupeve/individëve të ekstremizmit të dhunshëm në lagje

Faktorët e përgjithshëm tërheqës:

- “Idealet” e shtrembëruara nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, si p.sh. ideja e kalifatit apo arritja e barazisë social-ekonomike

Nxitësit individualë:

- Përkatësia (identiteti) i fituar në grupin ekstremist të dhunshëm
- Stimujt financiarë që ofrohen nga grupi ekstremist i dhunshëm
- Dëshira për aventurë



Burimi: Hedayah, 2021, Faktorët që kontribuojnë në radikalizim: Një kuadër konceptual.⁹

Në këtë këndvështrim, përpjekjet R&R duhet të kenë në qendër të vëmendjes faktorët nxitës të EDH dhe forcimin e qëndresës komunitare ndaj këtij fenomeni. Trajtimi i familjeve që kthehen nga zonat e konfliktit duhet të adresojë përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse një sërë sfidash socio-ekonomike, politike dhe shoqërore me të cilat përballen të kthyerit. Kthimi në vendlindje është një proces sfidues jo vetëm për individët e kthyer të cilët pëballen me vështirësitë e riintegrit në komunitet, por edhe për institucionet të cilat duhet të marrin masat e duhura për të trajtuar nevojat e të kthyerve. Për më tepër, institucionet duhet të monitorojnë vazhdimisht të kthyerit për t'u siguruar që ata nuk përhapin ideologji ekstremiste dhe nuk përbëjnë kërcënim

9 Mattei, Ch., & Zeiger, S. (2021). Factors Contributing to Radicalization : A conceptual Framework. Hedayah. E disponueshme në https://hedayahcenter.org/app/uploads/2021/10/Factors-Contributing-to-Radicalization_a-conceptual-framework_Final.pdf.

për sigurinë publike. Procesi i trajtimit të familjeve të kthyer nga zonat e konfliktit nuk është i njëjtë dhe i unifikuar për të gjitha shtetet. Duke u bazuar në dinamikën dhe kompleksitetin e personave të kthyer, shtetet mund të përzgjedhin mes “qasjes së ashpër” ose “qasjes së butë”. “Qasja e ashpër” ka të bëjë me ndjekjen penale dhe burgosjen e të rikthyerve, ndërkohë që “qasja e butë” konsiston në riintegrimin përmes pjesëmarrjes komunitare. Kjo e fundit e vë theksin tek roli i rëndësishëm që kanë aktorët dhe institucionet e qeverisjes vendore në trajtimin e këtij fenomeni.¹⁰

Shqipëria ka përkrahur përgjithësisht “qasjen e butë” në trajtimin e shtetasve të kthyer nga zonat e konfliktit. Suksesi i nismave të tilla konsiston në bashkëpunimin dhe koordinimin sa më efikas ndërinstitucional, përmes qasjeve shumë-aktoriale dhe partneritetit midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Një rol të rëndësishëm në gjithë këtë proces gjithëpërfshirës luan edhe Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm e cila është përgjegjëse për koordinimin ndërinstitucional me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, mbështetjen e institucioneve vendore, si dhe monitorimin e vazhdueshëm e të gjithë procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të të kthyerve.¹¹ Megjithatë, përpos përpjekjeve të deritanishme për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional në lidhje me EDH, riintegrimi i qëndrueshëm i shtetasve shqiptarë nga Siria kërkon një bashkëpunim sa më dinamik mes aktorëve vendorë, qendrorë, institucioneve ligjzbatuese dhe shoqërisë civile.

2.2 Gratë dhe fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit si grupe të rrezikuara në nevojë

Kuadri ligjor dhe strategjik shqiptar ka shumë përkufizime të personave që përfshihen në kategorinë e grupeve të cënueshme. Strategjitë sektoriale dhe kuadri nënligjor përcakton sipas tematikës kategorinë e grupeve të cënueshme që mund të përfitojnë nga shërbimet apo programe të caktuara të cilat kanë në fokus të punës së tyre veçanërisht personat që kanë nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje sociale. Përcaktimi i grupeve në nevojë për këtë modul u mbështet duke marrë si referencë përcaktimet e ndryshme për grupet në nevojë në një sërë dokumentesh strategjike kombëtare dhe ligjore. Më konkretisht, këto dokumente janë: VKM Nr. 56, datë 31.1.2018,

10 Fetiu, A., Mishkova, D., Bećirević, E., Stanchev, E., Vrugtman, L., Petrović, P., Evstatiev, A., Doklev, A. (2020). D5.1 Policy brief summarising the EU and other stakeholder's prevention strategy towards violent extremism in the region, the Balkans. PreveX.

11 VKM 1137/2020; Aktualisht, Qendra CVE është duke punuar për hartimin e një strategjie të re për të luftuar EDH dhe për trajtimin e sfidave në lidhje me rehabilitimin dhe procesin e riintegrit të të kthyerve.

“Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”; Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020- 2023). Njëkohësisht, të gjitha strategjitë ndërsektoriale u kushtojnë një vëmendje të veçantë aspekteve të veçanta të proceseve R&R.

Në rastin e Kosovës, personat e kthyer nga zonat e konfliktit gëzojnë një status të veçantë dhe mund të kategorizohen si grupe të cenueshme në nevojë për shkak të kushteve të pafavorshme ekonomike, sociale dhe emocionale.¹² Grupet e cenueshme janë grupe të veçanta të të riatdhesuarve, të cilët për shkak të karakteristikave të tyre kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim të veçantë. Megjithatë, për shkak të statusit të paqartë të gjendjes civile¹³, kuadri ligjor shqiptar i përjashton gratë dhe fëmijët e riatdhesuar nga zonat e konfliktit si kategori përfituese të skemave dhe programeve publike të akorduara për kategoritë e grupeve në nevojë.

Ndonëse në rastin e Shqipërisë këto grupe nuk gëzojnë status të veçantë për shkak të cenueshmërisë, ata përbëjnë një grup që duhet të jetë subjekt i mbrojtjes së veçantë. Duke pasur parasysh nevojat e specifike të këtij grupi është tejet e rëndësishme që punonjësit e vijës së parë të marrin në konsideratë cenueshmërinë e tyre të shumëfishtë gjatë menaxhimit të rasteve dhe përcaktimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve. Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër i profilit të grave dhe fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit.

12 Strategjia e Riintegritit të Personave të Riatdhesuar 2018-2022 për Kosovën përcakton personat e riatdhesuar nga zonat e konfliktit si grupe specifike të cenueshme. Strategjia e Riintegritit të Personave të Riatdhesuar 2018-2022 për Kosovën i kushton vëmendje të veçantë mbështetjes së grupeve cenueshme/specifike të personave të riatdhesuar, ku përfshihen edhe personat e kthyer nga zonat e konfliktit. Strategjia përcakton se “Grupet e Cenueshme (GC) janë personat e riatdhesuar, të cilët kanë nevojë për masa të veçanta të riintegritit si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, apo si pasojë e gjendjes së tyre familjare, gjinisë, moshës, analfabetizmit apo arsyeve të ngjashme, ose personat të cilëve u mungojnë njohuritë e duhura të gjuhëve zyrtare të Kosovës”. Këto grupe mund të përfitojnë nga skemat dhe shërbimet e specializuara të nevojshme me qëllim riintegrimin e tyre të qëndrueshëm në shoqëri. Akesuar më 23 Prill 2022. E disponueshme në <https://bit.ly/3QQmbHF>

13 Gratë e riatdhesuara nga zonat e konfliktit e kanë të pamundur të vërtetojnë statusin e kryefamiljarit për shkak të mungesës së një dokumenti ligjor (Akti i vdekjes ose vendimin e gjykatës për shpalljen e bashkëshortit të zhdukur)

2.3 Profili i grave dhe fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit

Gratë me fëmijë që kthehen nga zonat e konfliktit kategorizohen shpesh herë si grupe të cenueshëm dhe kërkojnë mbështetje dhe angazhim më të lartë nga shërbimet sociale¹⁴. Gratë e kthyer mund të ndihen të përjashtuara për shkak të vetëbesimit të ulët, izolimit dhe stigmatizimit që mund të përjetojnë në komunitetin pritës. Ato mund të kenë qenë dëshmitare apo viktimat e dhunës ekstreme dhe kanë jetuar në kushte të pasigurta dhe jo të shëndetëshme.

Ekspozimi ndaj dhunës brutale dhe traumave që kanë përjetuar në vendet e konfliktit rrit predispozitën për çrregullimet e stresit post-traumatik. Shenjat e stresit post-traumatik karakterizohen nga simptoma të tilla si pagjumësia, ankthi, depresioni, kontrolli i ulët ndaj impulseve, probleme me menaxhimin e zemërimit, agresioni dhe dhuna në situata shoqërore.¹⁵ Qëndrimi për një kohët të gjatë në zonat e konfliktit mund të ketë shkaktuar apati dhe mpirje emocionale, të cilat bëjnë të nevojshme trajtimin afatgjatë në mënyrë që gratë të rifitojnë besimin dhe aftësitë socializuese.

Riintegrimi social paraqet sfida për gratë e kthyer nga zonat e konfliktit, siç janë stigma, mungesa e lidhjeve shoqërore dhe konfliktet familjare. Ato mund të përjetojnë ndjenjën e turp-it, humbjes, dështimit, ankthit, pasigurisë dhe stresit, të cilat bëhen pengesë në procesin e riintegrit. Në kategorinë e personave të kthyer nga zonat e konfliktit, fëmijët janë veçanërisht ndër grupet më të cenueshëm. Fëmijët kanë qenë dëshmitarë dhe viktimat e dhunës dhe abuzimit ekstrem.

Një ekspozim i tillë sigurisht që ndikon negativisht në zhvillimin e fëmijës dhe lë pasojat afatgjate nëse nuk trajtohen siç duhet nga punonjësit e vijës së parë.¹⁶ Si rrjedhojë, **punonjësit që merren drejtpërsëdrejti me fëmijët duhet të marrin parasysh pikat e mëposhtme gjatë hartimit të ndërhyrjeve dhe ofrimit të shërbimeve:**

1

Fëmijët që jetojnë apo rriten në zonat e konfliktit janë veçanërisht të cenueshëm për shkak të abuzimeve dhe dhunës me të cilat janë përballur, si për shkak të faktit se zhvillimi i tyre normal social, moral, emocional dhe njohës iu është ndërprerë nga lufta. Ekspozimi ndaj traumës është edhe më i madh në rastet kur familjet ndahen, ose kur fëmijët kanë udhëtuar vetëm.

14 Po aty.

15 Meines, M., Molenkamp, M., Ramadan, O. and Ranstorp, M. (2017). Ran manual. Responses to returnees: Foreign terrorist fighters and their families. RAN. E disponueshme në <https://bit.ly/3OnNx6e>

16 Ndonëse fëmijët konsiderohen përgjithësisht si viktimat kryesore, ngjarjet në Siri dhe Irak kanë treguar që fëmijët në një moshë edhe 9 vjeç mund të paraqesin rrezik, qoftë në një periudhë afatshkurtër apo afatgjatë.

2

Fëmijët e ekspozuar ndaj konfliktit të armatosur ka shumë të ngjarë të përballen me trauma të shumëfishta dhe të vazhdueshme si dhuna ndaj individit/në familje, abuzimi seksual, uria, kequshqyerja, neglizhenca dhe braktisja. Ekspozimi ndaj traumës së shumëfishtë dhe të përsëritur paraqet rrezik për zhvillimin dhe gjendjen e përgjithshme të një fëmije.¹⁷ Për më tepër, procesi i zhvendosjes dhe riintegrimi në vendet e origjinës mund të rrisë nivelin e traumës. Kjo e fundit mund të shkaktohet nga stigmatizimi, përjashtimi social, kushtet e pafavorshme socio-ekonomike të familjes dhe mungesa e rrjeteve mbështetëse.¹⁸ Fëmijët e moshave të ndryshme mund të përballen me pasojat negative të bullizmit nga bashkëmoshatarët e tyre.

3

Kur fëmijët kanë qenë të përfshirë në dhunë, ata nuk janë të aftë të kuptojnë qartë pasojat e sjelljes së tyre dhe aq më tepër të pohojnë pjesëmarrjen e tyre në veprime të dhunshme. Edukimi i një fëmije, si dhe zhvillimi i tyre biologjik, përcakton në cilën moshë ai ose ajo mund të kuptojë pasojat e veprimeve të tij / saj. Ashtu si “fëmijët ushtarë”, fëmijët e kthyer nga lufta mund të shihen si viktimat, por në disa raste edhe si autorë të këtyre veprave. Për këtë arsye, monitorimi i vazhdueshëm i tyre nga punonjësit e vijës së parë është tejet i rëndësishëm.

4

Edhe pse fëmijët e kthyer janë larg zonës së konfliktit dhe në një vend më të sigurt, punonjësit duhet të jenë të vetëdijshëm që kjo është ende një periudhë tranzitore për fëmijët dhe atyre u duhet kohë për t'u stabilizuar në mjedisin ku kthehen. Situata bëhet akoma më e vështirë në kushtet kur ata jetojnë vetëm me njërin prind apo janë nën kujdesin e familjarëve të tjerë. Faktorë të tillë bëhen pengesë për trajtimin e traumave dhe ndërtimin e qëndresës kundër EDH.

17 Kohrt, BA., Jordans, MJD., Koirala, S. et al (2014). Designing Mental Health Interventions Informed by Child Development and Human Biology Theory: A Social Ecology Intervention for Child Soldiers in Nepal. *American Journal of Human Biology*, vol. 27, f. 27-40.

18 Fazel, M., Reed, R. V., Panter-Brick, C., & Stein, A. (2012). Mental health of displaced and refugee children resettled in high-income countries: risk and protective factors. *The Lancet*, vol. 379(9812), f. 266-282.

5

Interesi më i mirë i fëmijëve: Pavarësisht nga mosha e fëmijës, promovimi i zhvillimit të elementeve të tillë si aftësitë ndërpersonale, menaxhimi i emocioneve, jeta e qëndrueshme familjare etj., janë thelbësore për të krijuar një mjedis sa më miqësor dhe të shëndetshëm i cili nxit potencialet e fëmijës dhe i bën ata më produktiv për shoqërinë. Për të arritur në rezultate të tilla është e rëndësishme që fëmijët e kthyer të gëzojnë të drejta të barabarta sikurse fëmijët e tjerë. Atyre duhet t'u ofrohet mundësia për të marrë të gjitha shërbimet të cilat duhet të përshtaten me nivelin e tyre të zhvillimit.

PJESA 3. Qasja e integruar dhe multidisiplinare në ofrimin e programeve R&R

3.1 Parimet për ofrimin e programeve R&R

Programet R&R duhet të administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke pasur në vëmendje përfshirjen sociale. Më konkretisht, këto parime mund të përmbledhen si më poshtë :

- **Gjithëpërfshirja dhe mbështetja shoqërore** – Ndërhyrjet R&R duhet të garantojnë marrjen e shërbimeve bazë të jetesës dhe të adresojë nevojat specifike të grupeve më në rrezik për mbrojtje. Personat të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet R&R kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë. Duke u nisur nga fakti që personat e kthyer nga zonat e konfliktit dhe kryesisht gratë dhe fëmijët, ndodhen në situatë të cënueshme është e rëndësishme të garantohet mbështetje e duhur për të marrë këto shërbime si dhe pjesëmarrje e barabartë në të gjitha sferat e jetës.
- **Qasja shumë-aktoriale dhe partneritetet** – Sistemi i shërbimeve R&R bazohet në idenë se integrimi do të jetë efektiv nëse aktorët publikë dhe jopublikë në nivele të ndryshme të qeverisjes bashkëpunojnë ngushtë dhe vendosin partneritetete për të lehtësuar aksesin në ofrimin e këtyre shërbimeve.
- **Barazia para ligjit dhe parimi i mosdiskriminimit** - Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit qëndrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë (neni 18) si edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të vitit 1948 (neni 2). Parimi kushtetues i barazisë para ligjit ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë, racës,

fesë, etnisë, gjuhës, bindjes politike, fetare e filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, ose për shkaqe të tjera. Të gjithë personat e riatdhesuar, pavarësisht nga mosha, gjinia, përkatësia etnike, feja dhe raca, përfshihen në procesin e riintegrit. Të gjitha shërbimet R&R duhet të kenë në qendër të vëmendjes së tyre respektimin e të drejtave dhe garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit para ligjit.

- **Shërbime të disponueshme** - nënkupton që këto shërbime si dhe infrastruktura e tyre në një vend të caktuar duhet të jetë në sasinë e mjaftueshme që të mbulojë veçanërisht nevojat e grupeve më në rrezik.
- **Garantimi i aksesueshmërisë** - nënkupton si aksesin fizik ashtu edhe të drejtën për të kërkuar dhe informuar në mënyra të përshtatshme për këto grupe. Garantimi i aksesueshmërisë realizohet nëpërmjet shmangies apo eliminimit të pengesave të të gjitha llojeve.
- **Pranueshmëria dhe përshtatshmëria** - nënkupton shërbimet që ofrohen duhet të respektojnë parimet e etikës, të jenë të përshtatshme nga pikëpamja kulturore si dhe e përkatësisë gjinore apo fetare.
- **Universaliteti** - nënkupton shërbimet R&R krijohen, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem me ligje që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.
- **Subsidiariteti/ Shërbime më pranë qytetarëve** - nënkupton shërbimet R&R ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.
- **Deinstitucionalizimi i shërbimeve** - nënkupton shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.
- **Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale** - nënkupton të dhënat personale të individit që trajtohet me shërbime R&R janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve R&R ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt i këtij ligji, për të cilat ka marrë djeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës. Në planin afatgjatë, integrimi i etikës në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve R&R mund të forcojë legjitimitetin e këtyre programeve tek komunitetet e synuara, mund të lehtësojë punën e punonjësve të fushës si dhe të nxisë bashkëpunimin e përgjithshëm të komuniteteve.

3.2 Qasja multi-aktoriale në programet R&R për personat e kthyer nga zonat e konfliktit

Rehabilitimi është faza ku punonjësit e vijës së parë përqendrohen në terapinë njohëse dhe të sjelljes për trajtimin dhe ndryshimin e sjelljeve të papërshtatshme. Qëllimi i rehabilitimit është të nxisë procesin e përfshirjes shoqërore të personit që kërkon të shkëputet nga qëndrimet dhe sjelljet e mëparshme radikale. Përmes këtij riaftësimi synohet që personi të pranojë së pari vetveten dhe identitetin e ri, të rifitojë funksionet e humbura si dhe të rivendosë statusin personal dhe shoqëror. Këto janë ndërhyrje për stabilitet psikologjik që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës, duke krijuar kështu mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë në jetën shoqërore. Në kontekstin e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, rehabilitimi përqendrohet gjithashtu në rritjen e qëndresës personale ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe shkëputjen e individëve nga influencat e grupit dhe sjelljet kriminale.¹⁹ Kjo mund të ndodhë pas shkëputjes nga një grup dhe/ose deradikalizimit, por mund të ndodhë edhe njëkohësisht gjatë këtyre proceseve. Për personat që kthehen nga zonat e konfliktit, rehabilitimi shërben si një mjet i vlefshëm për të ndryshuar ciklin e dhunës dhe mendësitë radikale përmes riintegritit funksional shoqëror.

Riintegrimi i referohet rivendosjes së lidhjeve shoqërore, familjare dhe komunitare si dhe pjesëmarrjes pozitive në shoqëri. Hartimi i programeve të suksesshme të riintegritit është me rëndësi të madhe jo vetëm për të parandaluar përsëritjen (recidivizmin), por edhe për të zbutur radikalizimin e mëtejshëm mes personave të kthyer dhe për të forcuar qëndresën komunitare ndaj EDH. Riintegrimi është një proces që duhet të vijojë paralelisht me rimëkëmbjen sociale, ekonomike dhe politike të individëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Përpjekjet për riintegrim janë më të suksesshme nëse përshtaten me programet që trajtojnë faktorët strukturorë që mund të kenë nxitur dhunën apo largimin drejt vendeve të konfliktit. Programet e riintegritit duhet të konceptohen duke pasur në vëmendje dinamikën e komunitetit që mundësoi radikalizimin.

19 Gyte, J., Zeiger, S., Hunter, Th. (2020). Blueprint of a rehabilitation and reintegration center. Guiding principles for rehabilitating and reintegrating returning foreign terrorist fighters and their family members. Hedayah.

Megjithatë, përgjigjet efektive varen jo vetëm nga ekzistenca dhe llogaridhënia e sistemeve të drejtësisë penale, por edhe nga disponueshmëria e burimeve për programe të individualizuara dhe të përshtatura për shkëputjen e LHT-ve.²⁰

3.3 Qasja e përshtatur sipas nevojave

Personat e kthyer nga zonat e konfliktit nuk janë një grupim homogjen individësh, por kanë nevoja specifike, që sigurisht kërkojnë që programet për ta të jenë të përshtatura sipas nevojave të veçanta që kanë.

Në mënyrë që programet R&R të jenë funksionale dhe të zbatueshme, përveç qasjes së përshtatur, ato duhet të përfshijnë të gjithë aktorët e duhur. Për trajtimin sa më mirë të nevojave personale, familjare dhe sociale të personave të kthyer nga zonat e konfliktit, planet vendore apo kombëtare të riintegritimit, duhet të harmonizohen në nivel institucional. Koordinimi në nivel kombëtar dhe vendor është i nevojshëm për të mbështetur planin shumë-aktorial të ndërhyrjes për riintegrimin e të kthyerve në shoqëri. Për këtë janë të nevojshme kapacitetet dhe bashkëpunimi efektiv mes aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë të përfshirë në R&R (përfshirë këtu edhe punonjësit e vijës së parë dhe mediat). Proceset R&R janë të suksesshme nëse punohet paraprakisht për forcimin e kohezionit social të komuniteteve pritëse. Personat që kthehen duhet të ndihen të mirëpritur dhe të pranuar jo vetëm nga familjarët, por edhe nga komuniteti, pasi përshtatja dhe riintegrimi është më i qëndrueshëm nëse ata gjejnë mbështetjen e duhur.

Një nga praktikat më pozitive që përmendet aktualisht në lidhje me programet R&R me bazë komunitare është përfshirja e aktorëve në nivel vendor që në momentin e hartimit të programeve si dhe gjatë zbatimit dhe monitorimit të tyre. Aktorët e përfshirë në këtë proces mund të jenë bashkia, policia, organizatat e shoqërisë civile, psikologët, punonjësit socialë, përfaqësuesit e komuniteteve fetare, familjet, miqtë, apo komuniteti i biznesit. Nga pikëpamja e “qasjes së butë”, proceset R&R përfshijnë përpjekjet e komunitet në nivel vendor për të krijuar marrëdhënie të besueshme me personat e kthyer dhe ndërmjet njëri-tjetrit. Politika e “qasjes së butë” është përkrahur si qasje efektive nga Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, ka si bazë “qasjen e të gjithë shoqërisë”, dhe që është evidentuar deri më tani se ka pasur shumë sukses, ku janë përfshirë aktorë shumë të rëndësishëm, siç janë organizatat e shoqërisë civile, komunitetet fetare, gratë, të rinjtë, komuniteti

20 Holmer and Shtuni, 2017


i donatorëve, organizatat ndërkombëtare etj. Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm i ka dhënë një rëndësi të madhe koordinimit ndërinstytucional për zbatimin dhe monitorimin e suksesshëm të programeve R&R, me fokus të veçantë te gratë / vajzat dhe fëmijët.²¹

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm u krijua si rezultat i një sërë masash që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë për të trajtuar shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm tek shtetasit shqiptarë që u bashkuan në radhët e organizatave ekstremiste në konfliktet në Lindjen e Mesme vitet e fundit, duke përfshirë të ashtuquajturin Shtet Islamik në Siri dhe Irak (ISIS). Në vitin 2015, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me VKM Nr. 930 “Mbi miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”, e cila parashikon përfshirjen e aktorëve kryesorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke promovuar vlerat demokratike dhe adresimin e shqetësimeve në nivel lokal që mund të nxisin radikalizimin. Pas miratimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Këshilli i Ministrave krijoi njëkohësisht Qendrën për Koordinimin Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri si një qendër për koordinimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë dhe praktikuesve të vijës së parë të përfshirë në përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri dhe rajon, duke ndarë praktikat më të mira dhe duke zhvilluar masa të bazuara në dëshmi efektive për të luftuar kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm. Qëllimet e Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm:

- Forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive;
- Inkurajimi i hulumtimit vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm;
- Forcimi i qëndresës së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet;

21 Qendra CVE Shqipëri (2021). “Socio-Economic Vulnerabilities and their Impact upon Radicalization of Women in Western Balkans”. E disponueshme në <https://bit.ly/3nj1Tcl>

- Ulja e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive.
- Qendra QKEDH synon të bashkëpunojë me aktorët e sektorit publik dhe privat për të ruajtur dhe promovuar vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë, si dhe ruajtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm .



Përdorimi dhe përshtatja e strukturave ekzistuese për bashkëpunim ndërinstucional siç janë **Grupet Teknike Ndërsektorale (GTN) apo Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)** janë të rëndësishme për të siguruar bashkëpunimin, efikasitetin dhe koordinimin mes të gjithë aktorëve.

Grupet Teknike Ndërsektorale

Kuadri ligjor (Neni 52 i Ligjit nr. 18/2017) parashikon se në çdo bashki dhe njësi administrative me mbi 3000 fëmijë ngrihet ad-hoc Grupi Teknik Ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës, me pjesëmarrje të aktoreve kryesorë të arsimit, shëndetësisë, policisë, shërbimeve sociale dhe aktorë të tjerë, të cilët identifikohen të rëndësishëm për rastin që trajtohet. Ky mekanizëm ligjor mundëson një ndërhyrje ndërsektorale të koordinuar. Grupet teknike ndërsektorale duhet të bazohen në procedurën e menaxhimit të rastit për vlerësimin e nevojave dhe ofrimin e shërbimeve të duhura.

Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike

Në procesin e hartimit të metodologjisë së ndërhyrjeve dhe garantimit të një qasjeje shumë-disiplinare, Shqipëria e orientoi krijimin e këshillave vendore të sigurisë publike si praktikë që ndërlidh punën parandaluese me qasjet e policimit në komunitet dhe çështjeve të sigurisë dhe rendit publik. Kjo praktikë është zbatuar në pothuaj të gjitha bashkitë e vendit dhe ka garantuar ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve si forma për trajtimin e rasteve që do të paraqiten pranë këshillave. Drejtuesi i KVSP-së në çdo bashki është kryetari i bashkisë dhe anëtarë të KVSP-së janë drejtuesit e lartë të institucioneve vendore, që bëjnë pjesë në mekanizmat kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore apo në mekanizmat kundër trafikimit.

Menaxhimi i rastit dhe Plani Individual i Veprimit

Çdo përpjekje për të riintegruar personat e kthyer duhet të fillojë me vlerësimin e nevojave të individit, duke përdorur metoda të veçanta për vlerësimin e rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm.²² Ky informacion i ndihmon

22 Bllaca, E. (2021). Udhëzues për punonjësit e administratës publike dhe strukturave shtetërore. Rreth mbështetjes rehabilituese dhe riintegruese për personat që kthehen nga zonat e konfliktit. IDM. E disponueshme në <https://idmalbania.org/practical-guidelines-for-frontliners-central-and-local-government-officials-police-officers-to-support-rr-for-returning-people-from-conflict-zones/>

punonjësit e vijës së parë të përcaktojnë nëse këta persona mund të përbëjnë ose jo kërcënim për shoqërinë dhe të hartojnë më tej planet e individualizuara të riintegritimit. Ekipi koordinues ndërinstitucional duhet të hartojë plane veprimi të përshtatshme për secilin të kthyer dhe duhet të ofrojë udhëzime të qarta se cilat institucione janë përgjegjëse për të realizuar takimet, për të vlerësuar rrezikun dhe për të biseduar me të kthyerit, të afërmit e tyre, miqtë dhe palët e interesuara. Plani Individual i Veprimit (PIV) është mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës për të mundësuar përmbushjen e nevojave të individit dhe referimin e tij në programe të ndryshme sociale. PIV përfaqëson një zinxhir të thjeshtë vendimmarrjeje që garanton shërbimet dhe përfitimet në përputhje me nevojat e individit që hyn në procesin e riintegritimit në komunitet.²³ Ky plan përmban:

- Të dhënat që konstatohen për gjendjen e individit dhe nevojat e tij;
- Shërbimet sociale që do të përfitojë individi në përputhje me nevojat e vlerësuara.

Metodologjia që ndiqet për menaxhimin e rastit ndjek kryesisht një rend kronologjik për hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar një vlerësim individual cilësor të nevojave të familjes, po kryesisht të fëmijës, nëse ka nevojë për mbrojtje, në përputhje me një qasje të bazuar tek të drejtat e fëmijës, respektin e dinjitetit, me qëllim shmangien e viktimizimit, duke i përfshirë fëmijët si aktorë të plotë në proces²⁴. Menaxhimi i rastit është metodologjia që siguron, hap pas hapi, ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij.

Faza 1: Planifikimi përcakton sesi duhet të kryhet vlerësimi, ku do të kërkohet informacioni dhe cilët aktorë do të përfshihen.

Faza 2: Mbledhja e informacionit përcakton llojet dhe mënyrën e mbledhjes së informacionit.

Faza 3: Verifikimi i informacionit përcakton kontrollin për ndryshimet e mundshme në informacionin e marrë, nëse është i paplotë apo nëse përmban pasaktësi.



23 IDM. (2021). Udhëzues për njësitë e qeverisjes vendore. Për mbështetjen në rehabilitimin dhe riintegrimin (R & R) e personave që kthehen nga zonat e konfliktit. IDM. E disponueshme në <https://bit.ly/39T17Qh>

24 Për më shumë informacion mbi procedurat e menaxhimit të rasteve referoju Udhëzuesit për Njësitë e Vetëqeverisjes vendore: Për mbështetjen në rehabilitimin dhe riintegrimin (R & R) e personave që kthehen nga zonat e konfliktit. <https://bit.ly/39T17Qh>

Faza 4: Analiza e informacionit ka të bëjë me të kuptuarit e informacionit, si lidhet me situatën e familjes, së fëmijës, nevojat dhe rreziqet e mundshme.

Faza 5: Ndërhyrja/veprimi është koordinimi mes aktorëve për të siguruar trajtimin dhe përmbushjen e plotë të nevojave të identifikuara.

Qëllimi parësor i menaxhimit të rasteve është dhënia e shërbimit për grupet e synuara. Në udhëzues propozohen disa nga shërbimet kryesore që duhet t'u ofrohen të kthyerve: ²⁵

Trajtimi mjekësor: Profesionistët vlerësojnë nevojën për trajtim mjekësor për shkak të dëmtimeve nga lufta, për sëmundjet ngjitëse ose çrregullimet mendore. Pas mbërritjes së të kthyerve në vend duhet të bëhen trajtimet dhe referimet e mëtejshme të rasteve tek specialistët mjekësorë. Është e rëndësishme që personat e kthyer të marrin menjëherë shërbimet shëndetësore parësore. Personi i kthyer duhet të jetë në gjendje të kontaktojë me mjekun e familjes sipas nevojës. Personi përgjegjës për rastin mund të lehtësojnë vendosjen e të kthyerit në kontakt me mjekun e tij / e saj të familjes.

Strehimi: Personi përgjegjës për rastin duhet të sigurohet që vendbanimi në të cilën do të jetojë i kthyeri është i sigurt për të dhe për komunitetin. Duke qenë se personat e kthyer duhet të përballen shpeshherë me stigmatizimin nga komuniteti, personi përgjegjës për rastin mund të marrë parasysh mundësitë që të gjejë vendbanim anonim nëse është e nevojshme apo e mundshme.


Financat: Personi përgjegjës për rastin duhet të ndihmojë të kthyerin të aplikojë, nëse është e nevojshme, për mbështetje financiare të skemat në nivel vendor apo kombëtar si dhe të ndihmojë me hapjen e llogarive bankare.

Punësimi/arsimi: Personi përgjegjës për rastin duhet të asistojë të kthyerin për t'u fuqizuar ekonomikisht dhe për të siguruar një pavarësi ekonomike. Këshillohet që i kthyeri të ndjekë kurseve formimi profesional me qëllim integrimin e mëtejshëm në tregun e punës. Personi përgjegjës për rastin bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për punësimin në bashki si dhe me zyrrat vendore të punësimit.

Trajtimi i shëndetit mendor: Personi përgjegjës për rastin duhet të mundësojë dhe të ndihmojë të kthyerin të kontaktojë me shërbimet vendore të shëndetit mendor nëse është e nevojshme. Personi i kthyer mund të përfitojë nga shërbimet vendore të shëndetit mendor (Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor) sipas nevojës, si dhe mbështetjen psikologjike, përmes këshillimit dhe ndihmës së specializuar.

25 Meines et.al, 2017, p.66

Çështjet ligjore: mund të ketë pyetje specifike juridike, siç është njohja zyrtare e fëmijëve të personave të kthyer, përcaktimi i kujdestarisë ligjore për fëmijët e pashoqëruar, me vendim gjykatë. Personat e kthyer mund të përfitojnë nga ndihma ligjore parësore ose dytësore falas, në varësi të rasteve dhe nevojave.



Angazhimi i komunitetit në programet R&R



Mjedisi shoqëror dhe ai familjar kanë një ndikim të madh në mbarëvajtjen e proceseve rehabilituese dhe risocializuese të të kthyerve. Punonjësit e vijës së parë duhet të marrin në konsideratë faktin se personat e kthyer mund të jenë duke kaluar një periudhë të vështirë edhe për shkak të vetëbesimit të ulët si pasojë e stigmatizimit të tyre nga komuniteti. Në mbështetje të menaxhimit të rasteve individuale, është me rëndësi që të merret parasysh edhe angazhimi i komunitetit si pjesë e procesit të riintegrit. Personat e kthyer kanë përjetuar trauma gjatë qëndrimit në kampet e luftës të cilat kanë lënë gjurmë në shëndetin mendor dhe mund të bëhen pengesë për ta në përpjekjet për të rifilluar një jetë normale. Këto përvoja traumatike mund të reflektohen dhe përcillen tek familjarët e tyre pas kthimit. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme që të punohet paralelisht edhe me familjarët e të kthyerve. Anëtarët e familjes mund të shërbejnë si ura lidhëse mes luftëtarëve të huaj të kthyer dhe komunitetit pritës pasi ata janë në dijeni të ngjarjeve që kanë përjetuar të kthyerit si dhe janë në gjendje të shprehin më lehtë nevojat e tyre tek anëtarët e tjerë të komunitetit.

Bashkimi me familjen dhe mjedisin shoqëror është një proces me rëndësi. Nëse familja dhe rrethi shoqëror janë përjashtues dhe jo mikpritës ndaj individëve të kthyer, punonjësit socialë duhet të identifikojnë pikat fokale në komunitet, të cilët janë të gatshëm të ofrojnë mbështetjen e duhur për një riintegrim të qëndrueshëm. Këta persona në varësi të rasteve mund të jenë udhëheqësit fetarë, përfaqësuesit e OJQ-ve, apo aktivistë të të drejtave të njeriut. Personat e kthyer mund të bëhen pjesë e komunitetit duke marrë pjesë në veprimtari shoqërore, edukative dhe socializuese me qëllim forcimin e lidhjeve shoqërore dhe shmangien e izolimit të individëve të kthyer.²⁶ Për të shmangur reagimet stigmatizuese nga komuniteti, i cili mund të refuzojë të ndërveprojë me të kthyerit, është me rëndësi të madhe që programet R&R të marrin parasysh nevojat e komunitetit me të njëjtin seriozitet me ato të të kthyerve. Komuniteti nuk duhet të ndihet i përjashtuar por të jetë i përgatitur për të mirëpritur luftëtarët e huaj të kthyer.²⁷ Mbështetja e komunitetit për shtetasit e kthyer mund të ndihmojë që këta të fundit të ndjehen pjesë e komunitetit, një element mjaft i rëndësishëm ky për vendosjen e marrëdhënieve pozitive me personat e kthyer.

26 Pilika, A. dhe Xhaho, A. (2021). Udhëzues për profesionistët e shëndetit mendor, psikologët dhe punonjësit socialë. Ndërhyrja psiko-sociale për personat e kthyer nga zonat e konfliktit. IDM. E disponueshme në <https://idmalbania.org/practical-guidelines-for-frontliners-central-and-local-government-officials-police-officers-to-support-rr-for-returning-people-from-conflict-zones/>

27 GCTF. (2016). "Malta Principles for Reintegrating Returning Foreign Terrorist Fighters," GCTF. E disponueshme në <https://bit.ly/3a0RJtj>

PJESA 4. Raste Studimore për zbatimin e programeve R&R

Në praktikat e deritanishme nuk ka një qasje të unifikuar të programeve të rehabilitimit dhe riintegritimit. Vende të ndryshme përmendin disa shembuj të suksesshëm veçanërisht në lidhje me angazhimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve R&R.

4.1 Rasti i Danimarkës - Modeli Aarhus ²⁸

Programi Aarhus trajton të gjitha llojet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit dhe bazohet në një bashkëpunim të ngritur në sistem mes shumë institucioneve. Ky program është zhvilluar shumë gjatë një dekade mes ofruesve të ndryshëm të shërbimeve sociale, sistemit arsimor, sistemit të kujdesit shëndetësor, policisë dhe shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë. Policia lokale është institucioni që drejton zbatimin e programit, megjithëse vetë programi përfshin bashkëpunimin mes bashkisë dhe policisë. Që prej vitit 2014, programi ofrohet edhe për luftëtarët e huaj të kthyer vullnetarisht, me kushtin që të mos kenë kryer krime dhe të jenë vlerësuar se nuk përbëjnë rrezik për komunitetin. Ky model funksionon me efektshmëri, ndërkohë që mban të hapur një linjë komunikimi mes personave të kthyer dhe qeverisjes vendore dhe konsiderohet si faktor kyç për rritjen e besimit të ndërsjellë.

28 Hemmingsen, A-S. (2015). An Introduction to the danish approach to countering and preventing extremism and Radicalization. Denmark: Danish Institute for International Studies. E disponueshme në <https://www.ft.dk/samling/20151/almDEL/reu/bilag/248/1617692.pdf>; Rijal Bin Hassan, A-S (2019). Denmark's De-radicalisation Programme for Returning Foreign Terrorist Fighters. Counter Terrorist Trends and Analyses Vol. 11, No. 3. pp. 13-16. E disponueshme në https://www.jstor.org/stable/26617829?seq=4#metadata_info_tab_contents.

Programi Aarhus i mbështet pjesëmarrësit të gjejnë punë dhe strehim, u ofron këshillim psikologjik (për t'i ndihmuar me trajtimin e çrregullimit të stresit post-traumatik) dhe kujdes mjekësor falas, si dhe u ofron mbështetje për familjen. Mentorë të trajnuar posaçërisht për këtë çështje (përfshirë këtu edhe ish ekstremistë të dhunshëm) luajnë një rol si persona reference për të kthyerit dhe i mbështesin ata jo vetëm për t'u kthyer në një jetë të rregullt por u japin edhe këshilla fetare.

4.2 Rasti i Gjermanisë: Hayat (OJQ si pjesë e një partneriteti publik-privat) ²⁹

Hayat (në turqisht dhe arabisht do të thotë “jetë”) është programi i parë gjerman për këshillimin e personave të përfshirë në grupet radikale ose që janë në rrugën e radikalizimit të dhunshëm xhihadist, përfshirë ata që udhëtojnë në Siri apo zona të tjera luftimi. Hayat u ofrohet prindërve, vëllezërve dhe motrave, shokëve, mësuesve, punëdhënësve, dhe kujtdo tjetër që ka një marrëdhënie me personin potencialisht në rrugën drejt radikalizimit (të dhunshëm). Më tej, Hayat punon drejtpërdrejt me personat e radikalizuar me qëllim që të krijojë një mjedis mundësues për të ndërprerë sjelljen radikale dhe për të bërë të mundur braktisjen e grupeve dhe ideologjive radikale. Që prej janarit 2012, Hayat është partnere e Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët, e cila ka ngritur një linjë të posaçme kombëtare këshillimi për radikalizimin. Kërkesat për asistencë mund t'i drejtohen drejtpërdrejtë Hayat-it me anë të telefonit apo e-mailit. Pas marrjes së kërkesës, Hayat bën vlerësimin e parë. Nëse nevojitet ndërhyrje këshillimi, Hayat vlerëson nëse kërkohet edhe pjesëmarrja e një pale të tretë. Hayat i lidh personat që e kontaktojnë me institucionet dhe shërbimet që mund të jenë në gjendje t'i ndihmojnë, në varësi të situatës (p.sh., me shkolla, shërbime sociale, dhe, me raste, me shërbimin e provës dhe policinë). Ndërhyrjet e këshillimit, nëse janë të nevojshme, ndryshojnë në varësi të rastit. Mbështetja për familjen është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e punës. Ky model thekson se “ekstremistët janë të vështirë për t'u bindur kur bindjet e tyre janë të rrënjosura në teologji; për këtë arsye, ndërhyrja e drejtpërdrejt nga një i huaj, edhe kur është një këshillues tejet i trajnuar i Hayat-it, nuk ka gjasë të ketë sukses. Ndërkohë, familja është zakonisht lidhja më e mirë emocionale me individin. Marrëdhëniet pozitive janë të rëndësishme. Hayat garanton të drejtat dhe sigurinë e atyre që e kontaktojnë si dhe ruan konfidencialitetin e komunikimeve. Megjithatë, edhe shërbimet e sigurisë mund të përshihen gjatë këtij procesi nëse vlerësohen

29 https://ec.europa.eu/home-affairs/networks/radicalisation-awareness-network-ran/collection-inspiring-practices/ran-practices/family-counselling-hayat-deutschland_en

si të nevojshme, ndonëse kjo bëhet pasi të jenë informuar më parë familjet e tyre. Hayat i inkurajon familjet t'i kontaktojnë vetë institucionet e sigurisë.

4.3 Rasti i Kosovës³⁰

Shërbimet që ofrohen për personat e riadhesuar përfshijnë pritjen e organizuar dhe asistencën menjëherë pas arritjes, informimin e të riadhesuarve për të drejtat e tyre, ndihmën pas arritjes, strehimin e përkohshëm në Qendrën e Akomodimit, përfitimet emergjente dhe masat për riintegrim të qëndrueshëm. Pas përfundimit të protokollit 72 orësh të emergjencës, shumica e personave të riadhesuar lihen të lirë të shkojnë pranë familjeve të tyre, me përjashtim të personave të shtruar në spital. Programi vijon me vlerësimin e nevojave dhe dy fazat e tjera të rehabilitimit dhe riintegrit. Në masat për riintegrim të qëndrueshëm, në parim, përfshihen mbështetja që të riadhesuarit të marrin shërbimet publike. Bazuar në nevojat e tyre, ata mund të përfitojnë nga skema të veçanta që ofrohen në kuadër të ndihmës dhe mbështetjes për kthim të qëndrueshëm që financohet në kuadër të masave të riintegrit. Fakti që të gjithë fëmijët dhe gratë kosovare të riadhesuara, duke përfshirë nëntë fëmijë jetimë, u lanë në kujdestarinë e familjeve të tyre, sinjalizoi një nivel fillestar të pranimit me efekte potencialisht të dobishme në procesin e përshtatjes dhe riintegrit të tyre. Gjatë fazës së parë, Divizioni për Parandalim dhe Riintegrim të personave të radikalizuar, në koordinim me institucionet e tjera qeveritare, bëri regjistrimin e të kthyerve në zyrën e gjendjes civile, lëshimin e dokumenteve personale të identifikimit, përfshirjen në skemat e ndihmës sociale dhe mundësoi strehimin sipas nevojës. Qendrat mjekësore në nivel vendor kanë ofruar vaksinim, shërbime dentare dhe kontrole të mëtejshme mjekësore. Fëmijët janë asistuar për t'u përfshirë lehtësisht në sistemin arsimor. Ata janë përfshirë njëkohësisht në aktivitete kulturore dhe sportive. Njëkohësisht, njësitë e shëndetit mendor zhvilluan seanca të veçanta me fëmijët dhe nënat e tyre, duke integruar anëtarët e tjerë të familjes në seanca të përbashkëta. Fëmijët u angazhuan edhe në terapi arti dhe lojëra argëtuese, të cilat kishin për qëllim t'i ndihmonin ata të përballonin traumën, zemërimin ose zhgënjimin, për të çliruar tensionin, si dhe për të shprehur dhe menaxhuar ndjenjat dhe emocionet e tyre përmes komunikimit joverbal.

30 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (2021). Zbërthimi i Përgjigjes së Kosovës ndaj të kthyerve nga Zonat e Luftës në Siri Dhe Irak. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. E disponueshme në http://www.qkss.org/repository/docs/violent-extremism-alb_256843.pdf

4.4 Rasti i Shqipërisë

Zbatimi i programeve R&R në Bashkinë Tiranë ³¹

Në vijim të procesit të riatdhesimit të shtetasve shqiptar nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, janë marrë masa për rehabilitimin, riintegrimin dhe risocializimin e tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore, nën koordinim e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Ky proces është kryer në bashkëpunim me strukturat e posaçme në Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Antiterrorit, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Shërbimin Social Shtetëror. Përmes Urdhrit Nr. 169, datë 01.11.2018, të Kryeministrit, është hartuar Plani Ndërinstitucional i Veprimit “Për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë që kthehen nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak”, ku për të gjitha institucionet shqiptare parashikohen masa për detyra konkrete, për shërbime si: asistencë mjekësore, psikologjike, sociale, ekonomike, si dhe ngritja e kapaciteteve logjistike e njerëzore për pritjen, shoqërimin, si dhe masat për rehabilitimin, riintegrimin dhe risocializimin e tyre në komunitet. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 578, datë 03.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve, i cili kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit dhe zbatimit të masës së mbrojtjes dhe deri në përfundimin e tyre, vlerëson rastet që janë në nevojë për mbrojtje dhe për sistemim afatgjatë.

Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sigurohet që në pikën kufitare të hyrjes nëpërmjet masave përgatitore dhe prezencës së profesionistëve të fushave të ndryshme. Të kthyerit gra e fëmijë akomodohen fillimisht, kundrejt pëlqimit, në një Qendër Pritëse, ku qëndrojnë përkohësisht për një periudhë kohe derisa projektohet e planifikohet vendosja e të kthyerve në një komunitet të caktuar, i vendosur në bashkëpunim dhe me dakordësinë e të kthyerve. Strukturat përgjegjëse, në përputhje me kompetencat dhe fushën e përgjegjësisë së tyre koordinojnë të gjitha veprimet e zhvendosjes të individit nga qendra pritëse në komunitet. Në çdo rast, interesi më i lartë i fëmijës do të jetë një konsideratë parësore.

31 Kontribut i Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, data 30.05.2022; Komunikim me email, Bashkia Tiranë, data 24.05.2022.

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në përgjithësi. Ajo nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendore të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijëve në territorin e bashkisë. Procesi i ri-integrimit të rasteve të kthyer nga zonat e konfliktit është ndërtuar duke u bazuar në një metodologji pune duke vendosur fëmijën në qendër të tij, sepse në Shqipëri është në zbatim një legjislacion i plotësuar, i cili ka për qëllim ndërtimin e një sistemi të integruar për mbrojtjen e fëmijëve.

Gjatë hartimit të planeve individuale të mbrojtjes për familjet në proces ri-integrimi është mbajtur në konsideratë parimi “fëmija nuk menaxhohet i ndarë nga familja, por PIM hartohet duke përfshirë edhe ndërhyrje për familjen”. Adresimi i situatës së të kthyerve bazuar në një qasje holistike, me fokus sigurimin e mbrojtjes së përshtatshme drejt rehabilitimit dhe riintegrit të të kthyerve edhe në kuadër të përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të të kthyerve nga zonat e konfliktit, fokusi në çështjet e sigurisë dhe ato të riintegrit të tyre socio-ekonomik është i të njëjtës vlerë nga pikëpamja e zbatimit të ligjit.

Në të gjithë procesin e menaxhimit të familjeve të riatdhesuara është e rëndësishme të theksohet se ndërhyrja për ofrimin e shërbimeve bëhet e koordinuar dhe e ndërlidhur mes aktorëve profesioniste, strukturave vendore dhe qëndrore në bashkëpunim me OSHC, ku një rol të rëndësishëm në gjithë procesin koordinues luan Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve është personi përgjegjës për rastin dhe mbledh në mënyrë periodike Grupin Teknik Ndërsektorial nga mbledhjet e të cilit ngrihet dhe rishqyrtohet Plani Individual i Mbrojtjes. Rastet janë koordinuar nën koordinimin e Qendrës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Bazuar në korrespondencën e vazhdueshme me Qendrën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe institucionet partnere punohet hap pas hapi për ri-integrimin e rastit. Në kuadër të planit individual të mbrojtjes³² për secilin fëmijë janë ofruar shërbimet si më poshtë:

- Mbështetje psikologjike në qendrat sociale sipas njësive administrative;
- Konsulta shëndetësore;
- Asistim në ndjekjen e procedurave për sigurimin e KMCAP për rastet me probleme shëndetësore;

32 PIM realizohet dhe ndiqet nga PMF sipas njësisë administrative ku është vendosur rasti

- Ofrimi i fizioterapisë për nënën;
- Regjistrim në çerdhe, kopsht dhe shkollë me asistencën e PMF-së;
- Rimbursim për pagesën e faturave të ujit dhe dritave;
- Rimbursim për pagesën e shpenzimeve të kontratës së qerasë;
- Mbështetje me pako ushqimore mujore përmes OSHC-ve;
- Kurse të formimit profesional;
- Programe të nxitjes së punësimit: praktikë pune e paguar;
- Program i vetëpunësimit: kapital themeltar për hapje biznesi;
- Pjesëmarrje në veprimtari sociale, kulturore dhe zbavitëse;
- Program pas-shkollor për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët;
- Ndhimë ligjore falas : Ndjekja e procedurave ligjore për regjistrimin e fëmijëve në Regjistrin e Gjendjes Civile.

Zbatimi i programit të parë pilot R&R në Bashkinë Cërrik ³³.

Që prej dhjetorit 2019, Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkinë Cërrik zbatuan një program 2-vjeçar për rehabilitimin dhe riintegrimin e 9 familjeve në kontekste të vështira sociale. Tipologjia e përzgjedhjes së këtyre familjeve u bë e kombinuar, me qëllim shmangien e çdo paragjykimi, stigmatizimi, apo profilizimi ndaj individëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Ky program konsiderohet i pari në Shqipëri për nga qasja specifike e përshtatur me kontekstin shqiptar dhe ndërhyrjet individuale shumëplanëshe sociale, ekonomike, ligjore, arsimore, shëndetësore dhe të shëndetit mendor për 41 persona: 16 të rritur (burra dhe gra) dhe 25 fëmijë. Ndër këta, 4 familje përfaqësojnë 6 të rritur dhe 11 fëmijë të kthyer nga zonat e konfliktit.

Në sajë të koordinimit ndërinstytucional dhe mbështetjes së ndërsjellë në nivel qendror dhe vendor, u bë i mundur vlerësimi i nevojave individuale për secilin individ, u hartuan protokollat individuale të menaxhimit të rastit, u përcaktuan dhe u buxhetuan hapat specifike të ndërhyrjeve, si dhe u dakordësua angazhimi personal i çdo individi (përfshi fëmijët, përmes kujdestarëve/ përfaqësuesve ligjorë) me anë të nënshkrimit të deklaratës së pëlqimit për nisjen e trajtimit. Pas konceptimit të rasteve të ndërhyrjes, Këshilli Bashkiak i Cërrikut miratoi planet individuale të trajtimit për qasjet rehabilituese dhe riintegruese me një afat 2-vjeçar. Në mënyrë periodike, çdo hap i plotësuar apo nevojë urgjente është trajtuar në takime mujore të

33 IANS, 2020. <https://ians-albania.org/content/training-manuals-rehabilitation>

të gjithë aktorëve të përfshirë. Veçantia e këtij programi lidhet me faktin se deri në atë moment nuk ishte ndërmarrë asnjë program apo ndërhyrje ndaj këtyre individëve dhe familjeve të tyre, për shkak të kthimit të tyre individual. Rikthimi i “heshtur” në komunitete nuk e kishte bërë të mundur trajtimin specifik përmes planeve integruese individuale. Përmes këtyre ndërhyrjeve, është bërë e mundur përfshirja në programet vendore të mbështetjes sociale për 11 individë të rritur dhe 5 fëmijë, rikthimi në shkollë dhe mbështetja psikologjike për 6 fëmijë, punësimi për 6 kryefamiljarë apo fëmijë të tyre (të rritur), vlerësimi i specializuar psikologjik dhe psikiatrik për 18 individë, si dhe vlerësimi mjekoligjor për 1 të mitur në konflikt me ligjin.

Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, së bashku me Qendrën Fokus “Në Ndihmë të fëmijëve” i kanë kushtuar një rëndësi specifike sistemit të koordinuar të menaxhimit të rastit, si dhe përgatitjes së 18 instrumenteve matës për të rritur dhe fëmijë, të cilët kanë përcaktuar nevojat për përmirësimin e trajtimit dhe rritjen e kujdesit për çdo nevojë të identifikuar nga ekipet profesionale shumëdisiplinare në terren. Për sa më sipër, janë ngritur kapacitetet e grupeve të terrenit, të të gjithë punonjësve përgjegjës për menaxhimin e rasteve të familjeve të personave të kthyer në të gjitha bashkitë e Shqipërisë. Trajnimet janë bazuar në modulën “Për rehabilitimin dhe reintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit” dhe modulën “Për adresimin e çrregullimit post-traumatik PTSD”

4.5 Rasti i Finlandes³⁴

Faza 0: Mbërritja dhe javët e para

Para mbërritjes së të kthyerve nga zonat e konfliktit në vendin e origjinës, autoritetet kryesore të përfshira në proces janë policia, Ministria për Punët e Jashtme dhe shërbimet e mirëqenies së fëmijëve. Në fazën parapërgatitore për të ndihmuar fëmijët dhe familjet që kthehen nga zonat e konfliktit, pikat fokale në nivelin vendor duhet të kenë parasysh aspektet e mëposhtme:

- Procesi i bashkëpunimit dhe caktimi i roleve dhe përgjegjësive duhet të jetë i qartë dhe duhet të përfshijë:
 - Praktikrat e bashkëpunimit mes qendrave për mirëqenien e fëmijëve, shërbimeve sociale të të rriturve dhe policisë vendore.
 - Bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve sociale dhe kujdesit shëndetësor p.sh., për inspektimet për çështjet e emigrimit, hetimin për dyshime të abuzimit fizik, referime në kujdesin mjekësor të specializuar, etj.
 - Rolin e edukimit dhe kujdesit të hershëm të fëmijës.
 - Personat e përfshirë duhet të kenë të dhënat e kontaktit të të gjithë punonjësve që marrin pjesë në proces.
- Procedurat për përcaktimin e shtetësisë dhe mundësisht për marrjen e testeve të ADN-së.
- Kontaktimin me OJQ-të dhe institucionet fetare, përfshirë planin e veprimit se si shërbimet e tyre mund të përfshihen në procesin e mbështetjes.
- Dakordësimi për procedurat e komunikimit në nivel vendor.

Procesi i mbështetjes afatgjatë fillon pas javëve të para të kthimit. Gjatë javëve të para prioritet ka akomodimi i fëmijëve dhe familjes.

Faza 1: Ndërtimi i elementeve të jetës së përditshme: 3 muaj pas javëve të para

Faza 1 e procesit të mbështetjes afatgjatë ka të bëjë me punën për të identifikuar nevojat për të krijuar një jetë normale për fëmijën dhe familjen. Mbështetja që i jepet fëmijës gjatë gjithë fazave duhet të jetë në pëputhje

34 Socca. (2021). National modelling for arranging long-term support measures for children returning from conflict zones and their family members. E disponueshme në <https://bit.ly/3bmX1Qu>

me nevojat e moshës biologjike, përpos faktit nëse fëmija jeton ose je me prindërit biologjikë. Qëllimi i fazës 1 është të lehtësojë integrimin në shoqëri të të kthyerve. Kjo fazë përfshin një periudhë 2 javore deri në 3 muaj pas mbërritjes.

Punonjësit e përfshirë dhe qëllimet e fazës së parë

Në muajt e parë është e rëndësishme të nxitet ndërverprimi pozitiv mes fëmijës dhe prindit. Në një qasje sistematike, personi i kthyer është i përfshirë ngushtë në sigurimin e informacionit personal dhe familjar për hartimin e një plani, i cili kontribuon në këtë proces. Punonjësi social i mirëqenies së fëmijëve mbikëqyr çështjet në lidhje me fëmijën dhe koordinon të gjitha palët e përfshira në ofrimin e shërbimeve për familjen. Punonjësit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve sociale krijojnë një plan individual veprimi për fëmijën, duke detajuar masat mbështetëse që duhet të ndërmerren. Aktorët e përfshirë në këtë fazë janë punonjësit e kujdesit shëndetësor parësor, psikologu dhe specialitete të tjera të kujdesit mjekësor sipas nevojës. Institucioni i Sigurimeve Shoqërore dhe qendrat e shërbimit social të të rriturve janë të përfshirë në bashkëpunim. Këta të fundit kanë një rol tejet të rëndësishëm në mbështetjen e prindërve dhe bashkëpunojnë ngushtë me shërbimet e mirëqenies së fëmijëve. Punonjësi i shërbimeve sociale është një partner kryesor në vlerësimin e situatës së të rriturve dhe në organizimin e shërbimeve për ta. Punonjësi social i mirëqenies së fëmijëve komunikon edhe me të afërmit e fëmijës dhe përcakton nëse ata mund ta mbështesin fëmijën dhe familjen. Çdo marrëdhënie pozitive duhet të kultivohet gjatë procesit të mbështetjes afatgjate të fëmijës. Është e rëndësishme që të sigurohet mbështetje psikosociale për fëmijën dhe prindërit. Punonjësit e mirëqenies sociale që bashkëveprojnë me familjen kanë përgjegjësi të pjesshme për këtë, por OJQ-të dhe komunitetet fetare janë, po ashtu, të rëndësishëm në këtë aspekt. Deradikalizimi, që synon shkëputjen e individëve nga ekstremizmi i dhunshëm, kërkon rritje të besimit përmes mbështetjes psikosociale në fazën 1. Në përgatitje të fazës tjetër në procesin e mbështetjes afatgjatë, punonjësi social i mirëqenies së fëmijës kontakton shkollën dhe bëhen përgatitjet për hyrjen e fëmijës në shkollë. Punonjësi social i mirëqenies së fëmijës përcakton gjithashtu rrjetin e njerëzve të afërt me fëmijën për të konsideruar nëse ata mund ta mbështesin fëmijën dhe familjen në të ardhmen.

Faza 2: Stabilizimi i mbështetjes dhe integrimi i fëmijës në shoqëri: 3 muaj deri në 1 vit pas mbërritjes

Faza 2 e procesit të mbështetjes afatgjatë përfshin integrimin e fëmijës në mjedisin shoqëror, e cila fillon me regjistrimin e fëmijës në shkollë ose në çerdhe. Nga ana tjetër prindërit mbështeten me programe për aftësim

profesional ose nxitjen e punësimit me qëllim sigurimin e pavarësisë ekonomike. Kjo fazë zgjat deri në fund të vitit të parë pas mbërritjes në Finlandë, duke filluar pas Fazës 1, d.m.th., rreth 3 muaj pas mbërritjes. Ajo që është thelbësore për fëmijën dhe prindin në këtë proces është ndërtimi i një jete të re dhe konsolidimi një identiteti të qëndrueshëm.

Aktorët dhe qëllimet në Fazën 2

Punonjësit e arsimit dhe ata që merren me kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme luajnë një rol të rëndësishëm në punën për stabilizimn shoqëror të personave që kthehen nga zonat e konfliktit Përveç punës me fëmijën, merren masa për të siguruar një mjedis sa më të sigurt për fëmijën dhe prindin. Për sa i përket qasjes në shërbimet e kujdesi shëndetësor, fëmija dhe anëtarët e tjerë të familjes mbështeten nga klinika e kujdesit për fëmijët, shërbimi i kujdesi shëndetësor shkollor dhe kujdesi mjekësor sipas nevojës. Mbështetja e ofruar nga të afërmit dhe rivendosja e marrëdhënieve të besimit është po aq e rëndësishme për të krijuar një stabilitet emocional në vijim. Fëmijëve duhet t'u sigurohet mbështetje sociale nga bashkëmoshatarët e tyre edhe në aspekte të tjera, si për shembull pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore apo aktivitete të tjera argëtuese sipas pëlqimeve të fëmijëve. Si fëmijëve ashtu edhe prindërve mund t'u sigurohet mbështetje nga aktivistë të shoqërisë civile, të cilët janë të angazhuar në proceset e deradikalizimit. Përpjeket për deradikalizim mund të jenë më të suksesshme kur punohet në grup sesa kur punohet individualisht, kjo për shkak se ruajtja e identitetit të grupit mund të jetë mbështetëse për individët në grup dhe mund ta bëjë akoma më të lehtë përqafimin e ndryshimit sesa në rastet kur punohet individualisht. Këto çështje duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të shërbimeve.

Faza 3: Funksionimi i jetës së përditshme, mbështetja e qëndrueshme: 1 deri në 5 vjet pas mbërritjes

Pasi ka kaluar një vit nga mbërritja, aktorët e ndryshëm vazhdojnë të punojnë me fëmijën dhe familjen sipas nevojës. Punonjësi social i mirëqenies së fëmijës mund të vazhdojë si punonjësi përgjegjës për rastin e familjes, duke vlerësuar nevojat për mbështetje të fëmijës dhe familjes dhe duke siguruar që familja merr mbështetjen e nevojshme. Aktorët e tjerë të përfshirë në proceset e arsimit dhe të mirëqenies vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm për ruajtjen e balancës në jetën e përditshme. Bashkëpunimi sistematik shumë-aktorial në ofrimin e mbështetjes dhe monitorimi i vazhdueshëm i rasteve janë thelbësore për një riintegrim sa më të qëndrueshëm në komunitet.

PJESA 5. Hartëzimi i Programeve R&R

Në këtë kre bëhet një hartëzim i programeve R&R sipas fushave dhe nënfushave kryesore të ndërhyrjes. Plani i ndërhyrjes ofron një përshkrim të shkurtër të shërbimit duke u fokusuar te nevojat e grupit në fjalë, të kuadrit ligjor dhe nënligjor, fushës së veprimit, institucioneve dhe personave përgjegjës si dhe të hapave dhe procedurave që duhet të ndiqen për marrjen e shërbimit. Programet R&R ndahen në pesë kategori kryesore: 5.1 Arsimimi; 5.2 Mbështetja shëndetësore; 5.3 Mbështetja psiko-sociale; 5.4 Strehimi; 5.5 Punësimi dhe formimi profesional; 5.6.Ndihma ligjore.



Arsimimi



Mbështetja
shëndetësore



Mbështetja
psiko-sociale



Strehimi



Punësimi
dhe formimi
profesional



Ndihma
ligjore



Arsimimi



Mbështetja shëndetësore



Mbështetja psiko-sociale



Strehimi



Punësimi dhe formimi profesional



Ndihma ligjore

5.1 Arsimimi

5.1.1 Arsimi parashkollor

Arsim parashkollor quhet shërbimi i ofruar **falas** nga shteti shqiptar dhe që përfshin arsimin dhe edukimin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç me qëllim zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të tyre, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin bazë. Fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, ndjekin arsimin parashkollor me të njëjtat kushte si ato të fëmijëve që kanë lindur dhe janë rritur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo është e qartë edhe në kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor, ku specifikisht përcaktohet:

1. Respektimi i individualitetit të fëmijës
2. Gjithëpërfshirja e fëmijës përtej çdo paragjykimi
3. Diversiteti kulturor si fakt dhe si vlerë
4. Dimensioni gjiror përtej stereotipisë

Shërbimi i arsimit parashkollor funksionin në përputhje dhe përmbushje të frymës së Kushtetutës së Shqipërisë dhe vlerave të përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore. Kuadri ligjor që rregullon mirëfunksionimin dhe dhënien e një shërbimi sa më cilësor të arsimit parashkollor përcakton edhe institucionet përgjegjëse të mirërritjes së fëmijëve të moshës 3-6 vjeç si dhe hapat e nevojshëm për regjistrimin e tyre në institucionet përkatëse. Regjistrimi i fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor është detyrim ligjor edhe pse ky arsimim nuk është i detyrueshëm, edhe në rastet kur fëmija i kthyer nga zonat e konfliktit nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm. Në këtë rast regjistrimi bëhet në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Baza ligjore: Ligji Nr. 69/2012, “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Urdhri

nr. 31/2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi Nr. 10/2021 “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit”, Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, si dhe të gjitha dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Institucionet përgjegjëse janë:

1. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve
2. Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar
3. Zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP)
4. Drejtoria e shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore
5. Zyra e arsimit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
6. Institucioni arsimor (kopshti)
7. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
8. Prindërit/personi me përgjegjësi prindërore

Regjistrimi i fëmijëve bëhet në kopshtet që ndodhen pranë njësisë së vendbanimit, por në rast kur ato kopshte janë të mbyllura apo nuk kanë më vende rekomandohet regjistrimi në një kopsht tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Certifikatë personale e fëmijës me fotografi e tre muajve të fundit
2. Certifikatë familjare
3. Vërtetim banimi
4. Certifikatë e vaksinave nga qendra shëndetësore
5. Konfirmimi i njërit nga prindërit që është në marrëdhënie pune

5.1.2 Arsimimi fillor dhe i mesëm

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga 2 cikle: arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët që kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyrueshëm, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësit janë të detyruar të ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç. Nxënësit që ka mbushur moshën 16 vjeç dhe nuk kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të

plotë, kanë të drejtë të regjistrohen për të përfunduar arsimin bazë me kohë të pjesshme.

Arsimi i mesëm i lartë përfshin gjimnazin dhe arsimimin profesional. Në klasën e 10-të me kohë të plotë pranohen nxënës me moshë jo më të madhe se 18 vjeç. Deri në moshën 21 vjeç lejohet frekuentimi i arsimit të mesëm të lartë 3-vjeçar, ndërsa ai 4-vjeçar lejohet deri në moshën 22 vjeç. Fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, ndjekin arsimin parauniversitar me të njëjtat kushte, të drejta dhe detyrime si ato të fëmijëve që kanë lindur dhe janë rritur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Funksionimi i sistemit të arsimit parauniversitar garantohet nga kuadri ligjor përkatës për arsimin dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në respekt të së drejtës kushtetuese mbi arsimimin pa u diskriminuar në bazë të gjinisë, racës, orientimit seksual, ngjyrës, etnisë apo çdo lloj paragjykimi tjetër i përcaktuar në legjislacionin shqiptar.

Baza ligjore: Ligji nr. 69/2012, “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Urdhri nr. 31/2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi nr. 10/2021 “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit”, Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, Marrëveshje bashkëpunimi mes MARS, MSHBS dhe MB nr. 7522/2018 “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore”, Urdhri nr. 292/2019 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 7522/2018”.

Institucionet përgjegjëse të arsimit bazë dhe të mesëm janë:

1. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve
2. Drejtoria e përgjithshme e arsimit parauniversitar (DPAP)
3. Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar (DRAP)
4. Zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP)
5. Njësia e vetëqeverisjes vendore, zyra e Arsimit
6. Institucioni arsimor (shkolla/gjimnazi)
7. Njësia për mbrojtjen e fëmijës
8. Prindërit/personat me përgjegjësi prindërore

Fëmijët kanë të drejtë të regjistrohen në institucionin arsimor (shkolla) që mbulon vendbanimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore. Shkolla jashtë zonës së banimit mund të bëjë regjistrimin e nxënësve vetëm mbas miratimit të zyrës vendore të arsimit.

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin në arsimin fillor të fëmijëve

1. Regjistrimi si qytetar në portalin e-Albania i prindit/personit me përgjegjësi prindërore të fëmijës
2. Plotësimi i formularit të regjistrimit nëpërmjet portalit e-Albania.
3. Dokumenti i kujdestarisë ligjore në rast regjistrimi nga personi që ka kujdestarinë ligjore

Në rast të përgjigjes negative nga e-Albania, regjistrimi kryhet pranë institucionit arsimor të vendbanimit ku kërkohet:

1. Certifikatë e lindjes së fëmijës
2. Vërtetim nëse ka ndjekur arsimin parashkollor
3. Vërtetim vendbanimi
4. Vërtetim vaksinimi dhe okulisti nga qendra shëndetësore
5. Dëftesën/dëftesat e përkthyer dhe të noterizuara në rast të ndjekjes së shkollës në shtetin e jetuar.

Në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, regjistrimi bëhet gjithsesi dhe në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve

5.1.3 Arsimi i mesëm

Fëmijët kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e 10-të, në gjimnaz ose shkollë e mesme të orientuar. Në gjimnaz kanë të drejtë të regjistrohen nxënësit që kanë përfunduar arsimin bazë në shkollat e zonës së gjimnazit. Gjimnazi, kur ka kapacitet, regjistron edhe nxënës jashtë zonës së banimit pas miratimit të ZVAP. Në shkollat e mesme të orientuara nxënësit regjistrohen sipas përcaktimeve të MARS duke pranuar edhe nxënës nga Bashkitë që nuk kanë shkolla të mesme të orientuara.

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin në arsimin e mesëm të lartë të nxënësve:

1. Regjistrimi si qytetar në portalin e-Albania i prindit/personit me përgjegjësi prindërore të fëmijës
2. Plotësimi i formularit të regjistrimit nëpërmjet portalit e-Albania.
3. Dëftesë lirimi e skanuar nga origjinali
4. Dokumenti i kujdestarisë ligjore në rast regjistrimi nga personi që ka kujdestarinë ligjore
5. Raport mjekësor (vetëm kur aplikohet për shkollë të mesme sportive)

Në rast të përgjigjes negative nga e-Albania, regjistrimi kryhet pranë institucionit arsimor të vendbanimit ku kërkohet:

1. Certifikatë personale e fëmijës me fotografi
2. Dëftesa e liritimit nga arsimit 9-vjeçar
3. Vërtetim vendbanimi
4. Dëftesën/dëftesat e përkthyer dhe të noterizuara në rast të ndjekjes së shkollës në shtetin e jetuar
5. Raporti mjekësor (vetëm kur aplikohet për shkollë të mesme sportive).

Në momentin e regjistrimit të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit në institucionet arsimore (shkollë/gjimnaz) përkatës, ky institucion ngre një komision të përbërë nga mësues dhe punonjës të shërbimit psikosocial me qëllim:²

1. Vlerësimin e nevojave arsimore dhe psikosociale të fëmijëve
2. Përcaktimin e klasës ku do të regjistrohet fëmija
3. Hartimin e planit individual mësimor për fëmijët
4. Hartimin e planit individual për riintegrimin e fëmijëve dhe siguron kurse të gjuhës shqipe
5. Sigurimin e teksteve shkollore
6. Vlerësimin me testim dhe caktimin e klasës ku regjistrohet nxënësi në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit arsimor të nevojshëm.

5.1.4 Arsimit i lartë

Arsimi luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kapitalit njerëzor, përcimin e njohurive, formimin intelektual duke qenë një nga bazat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Në universitetet shqiptare aplikohet sistemi i Bolonjës, standard i Bashkimit Evropian për arsimin e lartë. Universitetet shqiptare kanë 3 cikle studimi dhe përkatësisht: cikli I bachelor me një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh akademike, cikli i dytë përfshin programet master shkencor me kohëzgjatje prej 2 vite akademike, programme të integruara master shkencor me kohëzgjatje 5 dhe 6 vite akademike, master i arteve me kohe 2 vite akademike dhe master profesional me kohëzgjatje prej 1 ose 2 vite akademike, dhe cikli i iii përfshin programet master ekzekutiv dhe doktoraturën me kohëzgjatje jo më shumë se 3 vite akademike.

Të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë e kanë të gjithë ato individë që kanë përfunduar më sukses arsimin e mesëm, që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, institucionet e arsimit të lartë dhe të notës mesatare

që përcaktohet çdo vit akademik nga Këshilli i Ministrave, dhe të gjithë ata individë që plotësojnë kriteret e pranimit por që nuk kanë mundësi financiare për përballimin e arsimit të lartë.

Baza ligjore: Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi nr. 10/2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” i përditësuar, Udhëzimi nr. 6/2018 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matikulimit”, Ligji nr. 69/2012, “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”/

Institucionet përgjegjëse të arsimit të lartë janë:

1. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve:
 - Qendra e shërbimeve arsimore (QSHA)
 - Qendra ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)
 - Agjencia kombëtare e financimit të arsimit të lartë (AKFAL)
 - Agjencia kombëtare e kërkimit shkencor dhe inovacionit (AKKSH)
2. Institucionet e arsimit të lartë (universiteti)
3. Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar
4. Zyra vendore e arsimit parauniversitar
5. Drejtoria e institucionit arsimor (shkolla/gjimnazi)
6. Njësia e vetëqeverisjes vendore, zyra e arsimit

Nxënësit që kanë mbaruar maturën shtetërore duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi me përjashtim të atyre që kanë rezultuar të shkëlqyer.

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim në institucionet e arsimit të lartë janë:

1. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë)
2. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesa e pjekurisë.
3. Certifikata (lista) e notave
4. Dëftesë/diplomë e njësuar nga QSHA kur aplikanti ka studiuar jashtë vendit
5. Deklaratë personale (plotësohet në prani të punonjësit të sekretarisë

dhe nënshkruhet nga dy palët)

6. Dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, apo çdo dokument tjetër nga vendi nga ku është kthyer që vërteton njohjen e gjuhës shqipe

Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit, sekretaria shënon në regjistër tëvecantë datën dhe orën e dorëzimit, me pas kryen regjistrimin online, në prani të aplikantit, në portalin U-Albania. Formulari i gjeneruar nga sistemi U-Albania firmoset në dy kopje nga aplikanti dhe punonjësi i sekretarisë.



Arsimimi



Mbështetja shëndetësore



Mbështetja psiko-sociale



Strehimi



Punësimi dhe formimi profesional



Ndihma ligjore

5.2 Mbështetja shëndetësore

5.2.1 Kujdesi shëndetësor parësor

Kujdesi shëndetësor parësor konsiderohet një shërbim publik, themelor, pa kufizime, i garantuar nga shteti shqiptar nëpërmjet sistemit shëndetësor për parandalimin, diagnostikimin dhe kurimin e sëmundjeve, në mbrojtje të shëndetit të të gjithë qytetarëve që jetojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht gjinisë, kombësisë apo statusit ekonomik. Qytetarët përfitojnë nga ky shërbim në strukturat e kujdesit shëndetësor parësor që janë Qendrat Shëndetësore, brenda të cilave mjekët e përgjithshëm e të familjes dhe infermierët trajtojnë problemet e ndryshme shëndetësore. Individët e kthyer nga zonat e konfliktit marrin kujdes shëndetësor dhe në kushte të barabarta me ato që zbatohen për të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

Korniza e përgjithshme ligjore mbi bazën e të cilës ofrohet shërbimi shëndetësor parësor: Ligji nr. 10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 10138/2009 “Për shëndetin publik”, Ligji nr. 10383/2011 “Për sigurimin e detyrueshëm në kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 7870/1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi

nr. 419/2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, VKM nr. 737/2014 “Për financimin e shërbimeve publike të kujdesit shëndetësor në KSHP nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor”, Ligji nr. 8652/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe të gjitha akteve tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Institucionet përgjegjëse për ofrimin e një shërbimi cilësor të kujdesit shëndetësor parësor janë:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
3. Instituti i Shëndetit Publik
4. Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
5. Autoriteti Shëndetësor Rajonal (ARSH)
6. Drejtoria e Shëndetit Publik (DSHP)
7. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH)
8. Njësia e vetëqeverisjes vendore (Bashkia)
9. Qendra Shëndetësore
10. Mjeku i familjes

Shërbimet e ofruara në qendrat shëndetësore janë të detajuara në paketën bazë të Kujdesit të Shëndetit Parësor dhe përmbledhin:

1. Kujdesin në rastet e urgjencës
2. Kujdesin shëndetësor për mirërritjen e fëmijës
3. Kujdesin shëndetësor për gratë dhe shëndetin riprodhues
4. Kujdesin shëndetësor për të rriturit
5. Kujdesin shëndetësor për të moshuarit
6. Kujdesin shëndetësor mendor
7. Promocionin dhe edukimin shëndetësor

Çdo individ mund të regjistrohet pranë mjekut të familjes në qendrën shëndetësore të njësisë administrative ku banon. Çdo individ mund të ndryshojë mjekun e familjes një herë në vit. Mjeku i familjes hap kartelën mjekësore me të gjitha të dhënat personale dhe shëndetësore të pacientit dhe regjistron qytetarin në regjistrin themeltar të banorëve të cilët i mbulon me shërbimin shëndetësor.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Dokument identifikimi (kartë identiteti/pasaportë/certifikatë personale për fëmijët)
2. Vërtetim vendbanimi

Regjistrimi i individit pranë mjekut të familjes kryhet edhe online nëpërmjet portalit e-Albania:

1. Regjistrimi si qytetar në portalin e-Albania
2. Plotësimi të dhënave të kërkuara në formularin elektronik
3. Përzgjedhja e mjekut të familjes pranë të cilit kërkohet regjistrimi.
4. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rast të ndryshimit të mjekut të familjes, i cili mund të ndryshohet jo më shumë se një herë në vit.

5.2.3 Shërbimet dytësore dhe tretësore

Shërbimi shëndetësor ndaj shtetasve që kanë nevojë për diagnostikim, ekzaminim dhe/ose trajtim të përqendruar në spital, që nuk mund të ofrohen nga kujdesi shëndetësor parësor, ofrohet përmes shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor dhe atij terciar. Në shërbimin spitalor dytësor dhe terciar trajtohen patologjitë më të ndërlikuara të pacientëve. Shërbim spitalor dytësor i referohet atyre shërbimeve që jepen kryesisht në spitalet e rretheve (ditore, në nivel bashkie e në nivel qarku): shërbime mjekësore ambulatorie të specializuara dhe ato spitalore. Kujdesi shëndetësor tretësor i referohet shërbimeve mjekësore të specializuara që ofrohen nga specialistë, mjek dhe personel shëndetësor në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Kuadri ligjor mbi të cilin bazohet shërbimi të kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor është: Ligji nr. 10107/2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 10138/2009 “Për shëndetin publik”, Ligji nr. 9016/2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 62/2013, Ligji nr. 10383/2011 “Për sigurimin e detyrueshëm në kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 7870/1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji 7703/1993 “Për Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 307/2014 “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, VKM nr. 308/2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor” i ndryshuar, Vendimi nr. 419/2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, Vendimi nr. 7/2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Q.S.U.T”

Institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të kujdësit shëndetësor dytësor dhe tretësor janë:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
3. Instituti i Shëndetit Publik
4. Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
5. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë (ARSH)
6. Drejtoria e Shëndetit Publik (DSHP)
7. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH)
8. Drejtoria e Shërbimit Spitalor dhe organet drejtuese të spitalit
9. Mjeku i familjes dhe mjeku specialist

Për të përfituar shërbimin shëndetësor dytësor dhe tretësor, me përjashtim të rasteve të urgjencës mjekësore, pacientet që kanë nevojë për shërbim më të specializuar referohen nga mjeku i familjes me rekomandimin apo epikrizën përkatëse pranë shërbimit të specializuar ambulator. Në rast të diagnostikimit nga mjeku specialist, pacienti kthehet tek mjeku i familjes për mjekimin dhe merr mjekimin e përshkruar. Në rast të kundërt pacienti referohet më tej në shërbim spitalor, e më pas në shërbim tretësor nëse nevojitet trajtim më i specializuar.

Dokumentacioni i nevojshëm për rekomandimin nga mjeku i familjes:

1. Dokument identifikimi (kartë identiteti/pasaportë)
2. Karta e shëndetit
3. Vërtetim vendbanimi
4. Rekomandimi i dhënë nga mjeku i familjes është i vlefshëm për 6 ditë.

Rekomandimi për konsultë te mjeku specialist i lëshuar nga mjekut të familjes mund të ngarkohet edhe online nëpërmjet platformës e-Albania:

1. Regjistrimi si qytetar në portalin e-Albania
2. Ndjekja e hapave të kërkuara nga portali

Shërbimet farmaceutike dhe dentare

Shërbimi farmaceutik dhe dentar në Shqipëri mbulohet kryesisht nga sektori

privat. Farmacitë janë private dhe farmaci spitalore siç janë farmacitë që gjenden brenda strukturave spitalore. Individët e kategorive të veçanta, pavarësisht faktit nëse janë të siguruar apo jo, përfitojnë nga skema e rimbursimeve kur marrin ilaçet në subjektet farmaceutike që kanë kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor sipas listës së barnave të rimbursueshme apo që jepen falas (sëmundje tumorale dhe kronike). Rimbursimi e medikamenteve kushtëzohet nga kategoria në të cilën pacienti bën pjesë, pra shkalla e rimbursimit është e plotë ose e pjesshme.

Baza ligjore që rregullon ofrimin e shërbimit farmaceutik: Ligji nr. 10107/2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 10138/2009 “Për shëndetin publik”, Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimet farmaceutike” i ndryshuar, Ligji nr. 9150/2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 737/2014 “Mbi financimin e shërbimeve publike të kujdesit shëndetësor në KSHP nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor”, VKM nr. 307/2014 “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, Vendimi nr. 419/2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor” Vendimi 308/2020 “Për miratimin e paketës së trajtimit anti-Covid ambulator në banesë që do të financohet nga FSDKSH”, Udhëzimi nr. 6/2020 “Mbi lehtësimin e procedurave për pacientët që trajtohen me barna me rimbursim pranë farmacisë së QSUT”

Institucionet përgjegjëse:

- 1.** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- 2.** Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave
- 3.** Agjencia kombëtare e barnave dhe pajisjeve mjekësore
- 4.** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
- 5.** Drejtoria Rajonale e FSDKSH
- 6.** Instituti i Shëndetit Publik
- 7.** Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
- 8.** Urdhri i Farmacistëve
- 9.** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Universitar (DSHSU)
- 10.** Subjekti farmaceutik
- 11.** Mjeku i familjes dhe mjeku specialist

Dokumentacioni për të përfituar nga skema e rimbursimit:

1. Kartën e shëndetit
2. Dokumentin që vërteton kategorinë e pacientit (dokumenti është i ndryshëm nga kategoria në kategori)
3. Recetën e rimbursimit nga mjeku i familjes ose mjeku specialist i spitalit rajonal/bashkiak

Përsa i përket pacientëve të cilët trajtohen me barna me rimbursim pranë farmacisë së QSUT, shërbimi mjekësor universitar realizon edhe konsulta online me pacientin. Hapat e konsultës online dhe marrja e medikamenteve me rimbursim:

1. Konsulta mes mjekut specialist të QSUNT dhe pacientit bëhet nëpërmjet Telemjeksisë apo komunikim telefonik/elektronik
2. Mjeku specialist gjeneron recetën elektronike me rimbursim në sistemin e RX
3. Kodet e recetës elektronike dërgohen në farmacinë spitalore
4. Farmacia spitalore përgatit barnat dhe ia dorëzon Operatorit shpërndarës farmaceutik
5. Operatorit shpërndarës farmaceutik siguron dorëzimin e barnave me rimbursim në farmacinë e spitalit rajonal/bashkiak të cilët pastaj ia dorëzojnë pacientit dhe siguron shpërndarjen direkte për atë kategori individësh që janë të vetmuar dhe mbi 65 vjeç pensionistë.
6. Pacienti që trajtohet me këto barna është nën kontrollin e mjekut specialist të spitalit rajonal/bashkiak si dhe të mjekut të përgjithshëm dhe të familjes.

Shërbimi i shëndetit oral është i organizuar në: a) shërbim publik i cili ofrohet nga institucionet shëndetësore publike; dhe, b) shërbimi privat që ofrohet nga subjektet e licencuara. Në institucionet e shërbimit stomatologjik publik ofrohet shërbimi falas për disa kategori individësh dhe mbulohen pjesërisht nga shteti disa kategori të tjera. Në klinikat stomatologjike publike kryhen ekzaminime, diagnostikime dhe ndërhyrje parandaluese dhe kuruese të patologjive të gojës. Në rastet e urgjencës stomatologjike, shërbimi ofrohet nga institucionet publike spitalore dhe/ose ambulatorë.

Shërbimi dentar për nxënësit/studentët:

1. Ofrohet edhe në të gjitha institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm të cilat organizohen me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit.

2. Mjekët stomatolog në shkolla, kryejnë vizita rutinë, informojnë mbi rëndësinë e higjienës orale, ndërhyjnë në parandalimin të patologjisë në stadin e hershëm dhe kryejnë trajtime fillestare.
3. Për trajtimin e fëmijëve të moshës 0-18 vjeç me shërbimin dentar në institucionet arsimore kërkohet gjithmonë pëlqimi i prindit/kujdestarit që ka përgjegjësinë ligjore.

Personat në moshë madhore që duan të përfitojnë nga shërbimi dentar publik mund të paraqiten pranë qendrave shëndetësore/poliklinikave të rretheve të akredituara për marrjen e shërbimit publik.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Dokument identifikimi (kartë identiteti/pasaportë/certifikatë personale)
2. Rekomandimi i mjekut të familjes
3. Karta e shëndetit

Çdo pacient ka kartelën e tij në të cilën shënohen gjeneralitetet, ekzaminimet, ndërhyrjet dhe trajtimet e ndryshme. Pacienti informohet paraprakisht për kushtet e trajtimit, qoftë ky dhënë falas, i siguruar apo jo, nëse ka një pjesë që mbulohet nga sigurimi shëndetësor, të dhënat mbi teknikën, trajtimin, dhe recetat përkatëse të firmosura për rimbursim eventual.

Baza ligjore e shërbimit dentar: Ligji nr. 10107/2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 10138/2009 “Për shëndetin publik”, Ligji nr. 9928/2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut”, VKM nr. 307/2014 “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, Vendimi nr. 419/2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, Urdhër nr. 580/2012 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e shëndetit oral në Republikën e Shqipërisë”

Institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimit dentar:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Ministria e Arsimit
3. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)

4. Instituti i Shëndetit Publik
5. Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria Rajonale
6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
7. Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik
8. Klinika Stomatologjike Universitare
9. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë (ARSH)
10. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH)
11. Qendrat shëndetësore/poliklinikat
12. Urdhri i Stomatologut

Karta e shëndetit

Karta e shëndetit është një dokument i cili vërteton që personi që e zotëron është i siguar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe përfiton shërbimet shëndetësore pa pagesë ose më pagesë të pjesshme. Karta e shëndetit është dokument personal, i patjetërsueshëm dhe shpërndahet pa pagesë. Sigurimi shëndetësor mbulon gjithashtu edhe ato kategori të personave ekonomikisht jo aktivë, pagesa e kontributeve të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit apo burime të tjera të përcaktuara me ligj siç janë:

- Personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- Personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar
- Personat e regjistruar si të papunë-punëkërkues në Shërbimin Kombëtar të Punësimit
- Shtetasit e huaj azilkërkues
- Fëmijët nën moshën 18 vjeç
- Nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike
- Kategori personash që përcaktohen më ligje të veçanta
- Viktimat e trafikimit
- Personat e siguar vullnetarisht

Pajisja apo ripajisja më kartë të shëndetit bëhet në dy mënyra:

1. Duke u paraqitur pranë pikave të shpërndarjes së kartave
2. Online përmes portalit e-Albania

Dokumentacioni i kërkuar në rastin kur i siguruari paraqitet pranë pikave të shpërndarjes:

1. Dokument identifikimi (kartë identiteti/pasaportë/certifikatë për fëmijët deri në moshën 16 vjeç)
2. **Dokumenti që vërteton kategorinë përfituese** (ndryshon nga kategoria në kategori)

Në rastin kur aplikimi për Kartë të Shëndetit bëhet online hapat janë si më poshtë:

1. Identifikimi në portalin e-Albania
2. Zgjedhja e shërbimit “Kartë e Shëndetit”
3. Gjenerimi i kartës së shëndetit me vulë elektronike
4. Në rast të aplikimi për personat e moshës 0-18 vjeç aplikimi bëhet nga prindi kryefamiljar/ personi më përgjegjësi prindërore i regjistruar në portal

Pajisja e ripajisja me Kartën e Shëndetit bëhet në rastet kur:

1. Person i siguar nuk ka kartë shëndeti
2. Personi i siguar ka humbur apo ka dëmtuar kartën e shëndetit
3. Personi i siguar ka një kartë shëndeti të cilës i ka mbaruar afati i përfitimit për një apo disa kategori përfituese
4. Personi i siguar ndryshon mjekun e familjes

Në të gjitha rastet, për të aplikuar për Kartën e Shëndetit i siguruari duhet të jetë i regjistruar paraprakisht në regjistrin elektronik të mjekut të familjes, i cili bën saktësimin e të dhënave të personit. Afati i kartës së shëndetit varion sipas kategorisë të të siguarit.

Baza ligjore e shërbimit të Kartës së Shëndetit: Ligji nr. 10383/2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 7870/1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji 7703/1993 “Për Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 307/2014 “Për Regjistrimin dhe Identifikimin e Personave të Siguar nga Sigurimi i Detyrueshëm Shëndetësor”, Vendim nr. 955/2014 “Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore” i ndryshuar, Urdhër nr. 253/2017 “Për lehtësimin e kërkesave për shërbimet e ofruara nga Fondi”, Udhëzim nr. 17/2019 “Për identifikimin e të siguarve në skemën e sigurimit shëndetësor”.

Institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimit:

1. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
2. Drejtoria Rajonale e Fondit
3. Institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit sipas kategorive të të siguruarve
4. Qendrat shëndetësore



Arsimimi



Mbështetja
shëndetësore



Mbështetja
psiko-sociale



Strehimi



Punësimi
dhe formimi
profesional



Ndihma
ligjore

5.3 Mbështetja psiko-sociale

Mbrojtja Sociale përbën tërësinë e mekanizmave që përdoren nga organet shtetërore dhe private për lehtësimin e barrës së familjeve dhe individëve për një sërë nevojash dhe funksionesh të caktuara me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre. Mbrojtja sociale konsiston në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve që kanë si qëllim zbutjen e varfërisë, nxitjen e punësimit, mbrojtjen e kategorive vulnerabël me politika sociale, ofrimin e një arsimit cilësor, kujdesit të përshtatshëm shëndetësor, pjesëmarrjen shoqërore e kështu me radhë.

5.3.1 Asistenca Sociale

Asistenca sociale është mekanizmi nëpërmjet të cilit shteti shqiptar siguron një sërë ndërhyrjesh e shërbimesh dhe jep ndihmë sociale kategorive në nevojë që nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazike jetike. Ky mekanizëm përcakton dhe garanton ushtrimin, respektimin e të drejtës për asistencë sociale si dhe marrëdhëniet e financimit e të ofrimit e përfitimit të saj. Asistenca sociale jepet nëpërmjet skemës së ndihmës ekonomike, përfitimit për shkak të aftësisë së kufizuar ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore për individët dhe familjet në nevojë, me qëllim zbutje e varfërisë dhe përjashtimit shoqëror, ndihmës së menjëhershme sociale për foshnjat e porsalindura. Për të rritur efikasitetin dhe barazinë në akses dhe transparencën e skemave NE dhe PAK është krijuar Regjistri elektronik Kombëtar që përmirëson ndjeshëm

shërbimin të asistencës sociale. Personat që përfitojnë NE dhe PAK përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Llojet e përfitimit nga programi i asistencës sociale janë:

1. Pagesa e ndihmës ekonomike për individët dhe familjet në nevojë
2. Pagesat e aftësisë së kufizuar
3. Bonusin e bebes (ndihmë e menjëhershme financiare) për prindin/prindërit e foshnjës së porsalindur
4. Përfitime të tjera që garantohen me ligjin për Asistencën Sociale

Baza ligjore: Kushtetuta e Shqipërisë neni 52.2, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, VKM nr. 111/2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 182/2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe Ndhmësit Personal”, VKM nr. 597/2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

Institucionet përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e shërbimit të Asistencës Sociale:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Shërbimi Social Shtetëror
3. Institucioni i Avokatit të Popullit
4. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
5. Njësia e vetëqeverisjes vendore
6. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki
7. Administratori Shoqëror

5.3.2 Ndhma Ekonomike (NE)

Skema e Ndhmës Ekonomike (NE) është një nga instrumentet kryesor për zbutjen e varfërisë, dhe ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard jetese për vete dhe familjen e

tyre duke qenë krejtësisht pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme. Shërbimi i Ndhmës Ekonomike ka evoluar gjatë viteve duke u kthyer tashmë në një shërbim që ka si qëllim riintegrimin e personave në tregun e punës.

Përfitojnë ndihmën ekonomike:

1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme
2. Jetimet të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes sociale
3. Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë a me më shumë njëherësh, që janë familje në nevojë
4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre
5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes së menjëhershme nga Gjykata, të cilat nuk trajtohen nga institucionet e përkujdesit shoqëror.
6. Fëmijë pa kujdes prindëror të vendosur në shërbimin e kujdestarisë me vendim Gjykate

Aplikimi për të përfituar nga skema e Ndhmës Ekonomike bëhet pranë Administratorit shoqëror në bashki/njësi administrative nga data 01-10 të çdo muaji. Aplikimi bëhet online nga Administratori dhe hidhet në Regjistrin Elektronik Kombëtar të NE, vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e SHSSH nëpërmjet formulës së pikëzuar.

Dokumentet që duhen paraqitur nga familjet (kryefamiljari së bashku me bashkëshorten) pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme dhe familjet me fëmijëve të lindur trinjakë e me më shumë njëherësh:

1. Certifikatë e gjendjes familjare me shënimet përkatëse
2. Fotokopje e kartave të identitetit për personat e moshës mbi 18 vjeç
3. Certifikatë personale për fëmijët nën moshën 18 vjeç
4. Vërtetim shkolle për ata që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë (1 herë në vit)
5. Vërtetim shkolle për ata që ndjekin arsimin 9-vjeçar (2 herë në vit)
6. Librezate vaksinimit të fëmijëve (për të përfituar pagesën shtesë)
7. Fotokopje e librezës së energjisë elektrike (për rimbursim)
8. Certifikatë pronësie të tokës ose tapinë e tokës
9. Vërtetim që janë regjistruar si punëkërkues në zyrën e punës (mbi 18 vjeç dhe që nuk frekuentojnë arsimin e lartë)

10. Vërtetim page për personat e punësuar
11. Vërtetim page nga sigurimet shoqërore
12. Familjet që kanë invalid pune apo PAK, fotokopje të raportit mjekësor për PAK ose invalid pune
13. Në rast të procesit të divorcit mes bashkëshortëve, dokumentacioni paraqitet i ndarë nga secili prej tyre, bashkë me vërtetimin e Gjykatës për procesin e divorcit
14. Vërtetim i vuajtjes së dënimit për personat e ndaluar

Për jetimët që nuk janë në institucionet e përkujdesjes sociale

1. Fotokopje e kartës së identitetit
2. Kopjen e noterizuar të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror
3. Vërtetim shkolle për jetimët që ndjekin arsimin bazë (2 herë në vit)
4. Kopje të librezën e vaksinimit për jetimët që vaksinohen

Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në castin e punësimit të tyre:

1. Fotokopje e kartës së identitetit
2. Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore (lëshuar brenda 30 diteve të fundit)

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të mbrojtjes së menjëhershme nga Gjykata

1. Fotokopje e kartës së identitetit
2. Urdhrin e mbrojtje ose urdhrin menjëhershëm të mbrojtjes për personat që e përfitojnë atë me vendim Gjykate, të cilat nuk trajtohen nga institucionet e përkujdesit shoqëror

Fëmijë pa kujdes prindëror të vendosur në familje në shërbim kujdestarie

Për familjen kujdestare:

1. Kërkesë me shkrim
2. Certifikatë e gjendjes familjare dhe fotografi e prindërve
3. Dëshmi penaliteti për anëtarët e moshës mbi 14 vjeç
4. Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë fizike dhe mendore të prindërve të familjes kujdestare

5. Vërtetim nga qendra e punës apo tatim-taksa, mbi të ardhurat që kanë prindërit kujdestare dhe anëtarët e familjes
6. Dëftesë shkolle e fëmijëve, që ndjekin shkollën, të familjes kujdestare kërkuese
7. Referenca për familjen nga 2 persona, njëri prej të cilëve duhet të jetë përfaqësues i komunitetit në të cilën familja jeton

Për të miturin që është në shërbim kujdestarie:

1. Certifikatë personale me fotografi për fëmijët nën 16 vjeç
2. Kopje të kartës së identitetit për fëmijët mbi 16 vjeç
3. Certifikatë familjare
4. Raporti mjeko-ligjor për gjendjen fizike dhe mendore të fëmijës
5. Kopje të librezës së vaksinimit
6. Dëftesë shkolle nëse fëmija frekuenton një të tillë
7. Vërtetim nga institucioni i përkujdesit shoqëror, nëse fëmija përfiton të ardhura nga prindërit biologjikë
8. Raportet mbi takimet fillestare të fëmijëve dhe familjes
9. Plani individual të ofrimit të shërbimit të kujdestarisë

Në kuadër të dixhitalizimit të skemës NE, disa shërbime kryhen edhe online në portalin e-Albania siç është Vërtetimi i masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe Ndhimja ekonomike për individë:

1. Regjistrim në portalin e-Albania
2. Ndjekja e hapave të përcaktuar nga portal

Bazaligjore: Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597/2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Ligji nr. 9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Institucionet përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e shërbimit të Ndhimës Ekonomike (NE)

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale Shërbimit Social

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore
4. Njësia e vetëqeverisjes vendore/struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki
5. Këshilli Bashkiak
6. Administratori Shoqëror

5.3.3 Personat më Aftësi të Kufizuar (PAK)

Personat të cilëve u është kufizuar aftësia si pasojë e dëmtimeve fizike, te intelektit, mendore, shqisore, të lindur apo të fituar gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të ndryshme që nuk lidhen me punësimin, përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar. Aftësia e kufizuar vërtetohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Kriteret mjekësore që vlerësojnë aftësinë e kufizuar rregullohen nga legjislacioni në fuqi. Individët që aplikojnë për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar paraqiten pranë Administratorit shoqëror që mbulon zonën e vendbanimit.

Përfituesit e pagesës për Aftësinë e Kufizuar:

1. Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen nga KMCAP që janë të tillë pavarësisht shkakut dhe moshës
2. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë nga KMCAP, si dhe personat e paaftë për punë sipas KMCAP që nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit
3. Personat më aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë nga Komisioni Shumëdisiplinorë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar
4. Personat të deklaruar invalid pune nga KMCAP, që përfitojnë pension invaliditeti dhe si rrjedhojë pagesë për shtesë invaliditeti

Dokumentacioni i kërkuar për të përfituar pagesën e PAK

1. Kërkesë me shkrim
2. Fletë drejtimi për në KMCAP
3. Certifikatë familjare
4. Fotokopje e kartës së identitetit (mbi 16 vjeç) ose certifikatë personale me fotografi (nën 16 vjeç)
5. Epikrizën nga mjeku specialist, në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes, sa herë rivlerësohet aftësia e kufizuar
6. Ekzaminimet përkatëse sipas diagnozës (eko, grafi, skaner, analiza EKG, etj.)

7. Vërtetim i kryerjes së detyrimit ushtarak (para 2007)
8. Vërtetim i sigurimeve shoqërore sipas kategorisë së sëmundjes, vetëm për invalidët e punës që përfitojnë pagesë shtesë
9. Kërkesë me shkrim për t'u trajtuar me ndihmë ekonomike për statusin para/tetraplegjik e fotokopje e noterizuar e statusit
10. Dokumentacion për kompensim të energjisë elektrike/telefonisë fikse.

Kur personi me aftësi të kufizuar, me vendim të komisionit mjekësor, përcaktohet se ka nevojë për përkujdesje (kujdestar) duhet të paraqesë edhe keto dokumenta shtesë:

1. Fotokopje e kartës së identitetit
2. Certifikatë familjare
3. Raporti mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për përkujdesje
4. Deklaratë noteriale/vendim gjyqi, për kujdestarin e përzgjedhur nga personi me aftësi të kufizuar

Personat më aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, me apo pa shkëputje nga puna, çdo fillim viti akademik, paraqesin përveç dokumentacionit të përcaktuar edhe dokumentacionin e më poshtëm:

1. Vërtetim i nënshkruar nga titullari dhe sekretari i shkollës, për frekuentim që lëshohet çdo 3 muaj ku shënohen:
 - Emri dhe mbiemri i personit
 - Niveli i arsimit që ndjek
 - Viti shkollor dhe kohëzgjatja
2. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve për personat që ndjekin arsimin e lartë
3. Kopje e noterizuar të dëftesës shkollore të çdo viti dhe kopjen e noterizuar të diplomës së shkollës se mesme të lartë apo të lartë, kopje e dëshmisë së kursit të kualifikimit
4. Kopje të noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik

Në kategorinë e aftësisë së kufizuar dhe që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar bëjnë pjesë edhe të verbrit, të cilët ashtu si kategoritë e tjera PAK duhet të paraqesin pranë Administratorit shoqëror, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Fletë drejtimi për KMCAP
2. Certifikatë familjare
3. Fotokopje e kartës së identitetit (mbi 16 vjeç) ose certifikatë personale me fotografi (nën 16 vjeç)
4. Epikrizën nga mjeku specialist, në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes, sa herë rivlerësohet aftësia e kufizuar
5. Ekzaminimet përkatëse
6. Kërkesë me shkrim
7. Dokumentacion për kompensim të energjisës elektrike/telefonise fikse
8. Në rastin e personit që ka nevojë për përkujdesje, pra për kujdestar, dokumentacioni që paraqitet është i njëjtë me kujdestarin e kategorive të tjera të aftësisë së kufizuar, sa sipër

Në kuadër të dixhitalizimit, disa shërbime kryhen edhe online në portalin e-Albania siç është Vërtetimi i mbi pagesën e aftësisë së kufizuar (PAK):

1. Regjistrim në portalin e-Albania
2. Ndjekja e hapave të përcaktuar nga portali

Institucionet përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e shërbimit të pagesës për aftësinë e kufizuar:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale Shërbimit Social
3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore
4. Njësia e vetëqeverisjes vendore/struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki
5. Administratori Shoqëror

Baza ligjore për PAK: Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 182/2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe Ndihmësit Personal”, VKM nr. 722/2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe Ndihmësit Personal dhe të Strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, Vendim nr. 135/2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, Ligji nr. 8626/2000 “Mbi statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” i

ndryshuar, VKM nr. 31/2001 “Përfitimet nga statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, Ligji nr. 8098/1996 “Për statusin e të Verbrit” i ndryshuar, VKM nr. 277/1997 “Për përfitimet nga statusi i të Verbrit” i ndryshuar,

5.3.4 Shërbimet e kujdesit shoqëror

Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse që operojnë në Shqipëri, në ndjekje të politikave të shtetit shqiptar, për të ndihmuar qytetarët në përmbushjen e nevojave bazike të një jetese sa më dinjitoze, sigurimin e mirëqenies, pavarësisë, dhe përfshirjes shoqërore ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror sipas legjislacionit në fuqi. Shërbimet e kujdesit shoqëror përbëjnë një sistem të integruar përfitimesh dhe lehtësirash për individët dhe familjet që kanë nevojë për përkujdesje shoqërore. Duhet theksuar që Bashki të ndryshme ofrojnë shërbime të ndryshme, të cilat drejtohen dhe menaxhohen nga zyra e shërbimeve sociale në Bashki. Ofrimi i shërbimeve të ndryshme varet nga një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve dhe infrastrukturën e nevojshme për të garantuar dhënien e shërbimit. Sipas legjislacionit në fuqi “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, llojet e shërbimeve janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje:

1. Shërbime parashoqërore: informim, këshillim/online, mbështetje psiko-sociale, ndërhyrje e hershme
2. Shërbime komunitare: shërbimi në familje, në qendrat komunitare ditore ose gjysmë ditore kanë qëllim integrimin në komunitet (shërbime për higjenën, shërbime për arsimin, kujdesin shëndetësor, edukim, rehabilitim psiko-social, kalimi kohës së lirë etj.), shërbime alternative (kujdestari familjar për fëmijë pa kujdes prindëror, shtëpi-familje), shërbim multifunksional (rehabilitim fizik dhe psiko-social, këshillim ligjor apo çdo shërbim tjetër i nevojshëm), i emergjencës 72-orëshe (asistencë e menjëhershme për kategoritë në rrezik dhe situatë rruge), strehimi i mbrojtur për të pastrehët (viktima të dhunës, trafikimit dhe PAK)
3. Shërbime rezidenciale: në qendrat ku ofrohet strehim 24 orësh dhe afatgjatë për kategoritë në nevojë (kur kujdesi në shtëpi nuk është i mundur dhe pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore), qendrat e zhvillimit (terapi psiko-sociale, shërbim psikomotor, terapi riaftësimi në punë, terapi zhvillimi për personat deri në 21 vjeç), strehëzat (shërbim i përkohshëm që siguron strehim, ushqim, kujdes shëndetësor, edukim për individët, përfshirë fëmijët, që ndodhen në situatë emergjente, rruge dhe rreziku)

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë:

1. Familjet dhe çdo fëmijë, që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri, sipas legjislacionit në fuqi
2. Personat më aftësi të kufizuar
3. Të rritur me probleme sociale, viktima të dhunës, të trafikimit, varësisë ndaj drogës dhe alkoolit
4. Vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën 1 vjeç
5. Të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar dënimin dhe kanë nevojë për riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare nga vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët
6. Të moshuarit në nevojë
7. Individët që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme, por kundrejtë tarifave të përcaktuara, kanë të drejtë të kërkojnë sistemim të përkohshëm në qendrat rezidenciale apo komunitare.

Procesi i përfitimit të shërbimeve komunitare dhe rezidenciale fillon me kërkesën e paraqitur nga individi i interesuar, vazhdon me verifikimin e rastit nja punonjësi social/njësia e mbrojtjes së fëmijës, të dhënat regjistrohen më pas në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror. Kërkesa paraqitet nga:

1. Individi kërkues për marrjen e shërbimit
2. Punonjësi i njësisë së vetëqeverisjes vendore
3. Organizata jofitimprurëse që ofrojnë këto shërbime
4. Punonjës i policisë së shtetit
5. Çdo person i interesuar

Shërbimet në shtëpi për të moshuar dhe PAK, pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës:

1. Fotokopje e kartës së identiteti
2. Përbërjen familjare aktuale nga gjendja civile e vitit 2010
3. Epikriza shëndetësore dhe fotokopje e kartelës mjekësore
4. Verifikim i gjendjes social ekonomike të personit dhe familjes
5. Të ardhurat e familjes nga drejtoria e tatimeve

Shërbim në qendër komunitare multifunkzionale për të gjitha kategoritë në nevojë, pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës:

1. Fotokopje e kartës së identiteti
2. Përbërjen familjare aktuale nga gjendja civile e vitit 2010
3. Verifikim i gjendjes social ekonomike të personit dhe familjes
4. Të ardhurat e familjes nga drejtoria e tatimeve

Shërbimi në qendër ditore për fëmijë pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës:

1. Certifikatë lindjeje nga gjendja civile i vitit 2010
2. Certifikatë familjare nga gjendja civile i vitit 2010
3. Fotokopje e kartës së identitetit të prindërve
4. Verifikim i gjendjes social ekonomike të familjes
5. Raporti i organeve policore në rastin kur fëmija është i neglizhuar apo pa kujdes prindëror

Shërbim në qendër ditore për PAK pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës:

1. Certifikatë lindjeje nga gjendja civile i vitit 2010
2. Certifikatë familjare nga gjendja civile i vitit 2010
3. Verimin e komisionit përgjegjës për përcaktimin e aftësisë së kufizuar
4. Deklaratë me shkrim e noterizuar e pëlqimit të prindit/kujdestarit ligjor për pranimin në qendër ditore

Shërbim në qendër ditore ose **shërbim i strehimit afatgjatë** ose **shërbim në strehëz** për personat e moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit, përfitojnë pension social ose pension minimal, janë të vetmuar/të braktisur pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore:

1. Certifikatë nga gjendja civile e vitit 2010
2. Certifikatë familjare nga gjendja civile e vitit 2010
3. Raporti nga komisioni mjeko-ligjor që përcakton gjendjen shëndetësore
4. Vërtetim i sigurimeve shoqërore për masën e pensionit

5. Verifikim me gjendjen social-ekonomike të familjes
6. Vërtetim nga hipoteka dhe ALUIZNI që nuk zotëron pronë (për shërbimin në strehëz)
7. Vërtetim nga sistemi bankar që nuk ka burime financiare (për shërbimin në strehëz)

Shërbimi i emergjencës 72 orë ofrohet në mënyrë të menjëhershëm dhe pas bëhet akomodimi në institucionet e shërbimit shoqëror. I vetmi dokumentacion që nevojitet është:

1. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, për viktimat e dhunës në familje
2. Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes ose proces verbal i policisë, për fëmijët pa kujdes prindëror, të dhunuar, të shfrytëzuar, të abuzuar, fëmijë më aftësi të kufizuara
3. Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes ose procesverbali i policisë, për të moshuar të braktisur në situatë rruge

Shërbimi për të pastrehët mbi moshën 18 vjeç dhe që përfitojnë NE pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore:

1. Përbërjen familjare aktuale nga gjendja civile e vitit 2010
2. Verifikim i gjendjes social-ekonomike të familjes
3. Raport mjeko-ligjor që përcakton gjendjen shëndetësore të personit
4. Të ardhurat e familjes nga drejtoria e tatimeve
5. Verifikim i aplikimit për NE ose përfitim të NE
6. Informacion mbi pasuritë e paluajtshme nga zyra e hipotekës

Shërbimi i strehimit të mbrojtur ose **shërbime rezidenciale** (fëmijë 0-18 vjeç, gra/vajza) për viktimat e dhunës në familje pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës:

1. Urdhër i mbrojtje/urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes
2. Procesverbali i policisë
3. Raporti i vlerësimit të punonjësit social
4. Certifikatë familjare nga gjendja civile e vitit 2010
5. Raporti i komisionit mjeko-ligjor
6. Vërtetim nga zyra e hipotekës dhe ALUIZNI që nuk zotëron pronë (për shërbimin e strehimit të mbrojtur)

7. Të ardhurat e familjes nga drejtoria e tatimeve (për shërbimin e strehimit të mbrojtur)
8. Vendim i gjykatës për vendosjen në shërbimin rezidencial (për shërbimin rezidencial).

Shërbimi i strehimit të mbrojtur ose **shërbime rezidenciale** (fëmijë, persona mbi 18 vjeç shtetas shqiptarë apo të huaj) për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës

1. Deklaratë e firmosur nga përfituesi për pranimin për sistemim në qendër rezidenciale
2. Deklaratë konfidencialiteti të përkthyesit (kur viktimja është shtetas i huaj)
3. Lejen e informuar për intervistën formale
4. Formatin e përfundimit të intervistës formale
5. Formatin e përfundimit pa intervistë formale
6. Deklaratën e vendimit të informuar për ndihmë
7. Vlerësim psiko-social dhe të sigurisë së parakthimit vullnetar (për viktimën/at e riadhesuar)
8. Vlerësimin e situatës familjare para kthimit vullnetar të asistuar
9. Procesverbalet e referimit të punonjësit social rajonal dhe punonjësit të antitrafikut
10. Autorizim i prindit/kujdestarit ligjor për kthim të asistuar të të miturit/ve
11. Autorizim i prindit/kujdestarit ligjor për udhëtim të asistuar të të miturit/ve.

Shërbim rezidencial personat me aftësi të kufizuar nga 0-21 vjeç ose **shërbim i strehimit afatgjatë** për PAK pas kërkesës më shkrim dhe verifikimit të rastit nga punonjësi social i njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësia për mbrojtjen e fëmijës:

1. Certifikatë lindjeje nga gjendja civile e vitit 2010
2. Certifikatë familjare nga gjendja civile e vitit 2010
3. Vendimin e komisionit përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kufizuar
4. Verifikim i gjendjes social ekonomike dhe të ardhurat e personit dhe familjes

5. Vërtetim i shkollës që ka ndjekur apo po ndjek (për shërbimin rezidencial)
6. Deklaratë me shkrim për dhënien pëlqimit nga prindi/kujdestari ligjor për sistemimin në qendrën rezidenciale.

Shërbimet e përkujdesjes shoqërore dhe qendrat rezidenciale për fëmijët e moshës 0-18 vjeç që ndodhen në kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, pas kërkesës më shkrim nga të interesuarit:

1. Certifikatë e lindjes nga Gjendja civile e vitit 2010
2. Certifikatë familjare nga Gjendja civile e vitit 2010
3. Certifikatë e vdekjes së prindërve nga Gjendja civile e vitit 2010
4. Vendim i Gjykatës për heqjen e të drejtës prindërore
5. Deklaratë e nënës (në mungesë, deklarata e braktisjes në institucionet shëndetësore ku është braktisur fëmija), në rast të braktisjes së fëmijës
6. Epikrizën shëndetësore dhe kopje të kartelës mjekësore
7. Procesverbali i lindjes së fëmijës kur është i braktisur në maternitet
8. Procesverbali dhe urdhri i pranimit/transferimit të fëmijës me vendim komisioni (kur fëmija transferohet nga njëri institucion në tjetrin për shkak të moshës)
9. Fotokopje e kartës së identitetit të prindërve
10. Dokumenti i shkollës që ka ndjekur apo po ndjek fëmija
11. Deklaratë me shkrim për dhënien pëlqimit nga prindi/kujdestari ligjor për sistemimin e tij në institucion
12. Verifikim i gjendjes social ekonomike familjes
13. Dokumente të noterizuar të pronës/pronave, kur fëmija është trashëgimtar në rast të vdekjes së prindërve.

Baza ligjore mbi të cilën ofrohen shërbimet e përkujdesjes shoqërore: Kushtetuta e Shqipërisë neni 52.2, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 182/2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe Ndihmësit Personal”, VKM nr. 597/2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Vendim nr. 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit komunitar e rezidencial, kriteret e procedurat për përfitimin e tyre

dhe masën e shumë për shpenzime personale për përfituesit e shërbimet të organizuar”, Ligji nr. 136/2018 “Për miratimin e administrimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”.

Institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Shërbimi Social Shtetëror/Drejtoria Sociale Rajonale
3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror
4. Policia e Shtetit
5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore (qark/bashki/këshilli bashkiak)
6. Njësia e shërbimit social në njësinë e vetëqeverisjes vendore
7. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
8. Organizatat jo fitimprurëse të kontraktuara për ofrimin e shërbimeve.

5.3.5 Mbështetja psikologjike

Në ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, pjesë e rëndësishme është edhe mbështetja psikologjike, si standard i një shërbimi cilësor që jepet më qëllim përmbushjen e nevojave të një pjese vulnerabël të komunitetit të cilët mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë, siç janë familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit apo personat me aftësi të kufizuar. Mbështetja psikologjike në shërbimet e përkujdesjes sociale jepet nga profesionistë të fushës siç janë psikologët dhe/ose punonjësit social të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe qendrave sociale, si ato komunitare edhe ato rezidenciale.

Punonjësi social bën vlerësimin e nevojave psikologjike dhe sociale, ofron këshillim social me qëllim zgjidhjen e problemeve të lidhura me punësimin, strehimin, përfitimin e shërbimeve në shtëpi apo në qendrat sociale, situatave problematike në familje e komunitet. Punonjësi social ofron gjithashtu edhe këshillim psikologjik më qëllim mbështetjeje dhe lehtësimi të gjendjes në të cilën gjendet individi dhe/ose familja/kujdestarit ligjor. Menaxhon rastet që përfshijnë krijimin dhe nxitjen e bashkëpunimit mes profesionistëve të sektorit në funksion të përmirësimit të situatës psiko-sociale të individit/familjes ne nevojë.

Qendrat e përkujdesjes sociale kanë në organikën e tyre figurën e psikologun të licencuar, për trajtimin e rezidentëve që kanë nevojë për mbështetje psikologjike siç mund të jenë rastet e dhunës në familje, braktisja e të miturve nga prindërit, fëmijët e dhunuar apo në situatë rrugë, problemet që hasin personat më aftësi të kufizuar, braktisja e të moshuarve, riintegrimi

i personave të kthyer nga jashtë apo çdo target grupi tjetër që përfiton nga shërbimet sociale. Psikologu ofron trajtim terapeutik individual apo në grup dhe këshillim psikologjik për të nxitur përfituesit e shërbimeve shoqërore të shprehin ndjenjat e tyre, të diskutojnë mbi çfarë i shqetëson, të zhvillojnë njohje dhe marrëdhënie me të tjerët me qëllim rehabilitimin psiko-social dhe integrimin e tyre, pra kryen të gjitha veprimet dhe këshillimet sipas legjislacionit në fuqi.

Për mbështetjen psikologjike të të miturve kërkohet:

1. Deklaratë me shkrim i prindit/kujdestarit ligjor
2. Në rastin e qëndrimit të fëmijëve në qendra rezidenciale, miratimi i prindit nuk është i nevojshëm sepse qendra rezidenciale merr, me vendim Gjykate, kujdestarinë ligjore për fëmijën.

Për mbështetje psikologjike të të rriturve:

1. Kërkesa më shkrim e personit që kërkon trajtimin psikologjik.

Baza ligjore mbi të cilën ofrohet mbështetja psikologjike: Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Social në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 40/1026 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” Vendim nr. 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit komunitar e rezidencial, kriteret e procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimet të organizuar”, Ligji nr. 136/2018 “Për miratimin e administrimin e Regjistrimit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”, Ligji nr. 18/2018 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Institucionet përgjegjëse:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Shërbimi Social Shtetëror/Drejtoria Sociale Rajonale
3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore (qark/bashki/këshilli bashkiak)
5. Njësia e shërbimit social në njësinë e vetëqeverisjes vendore
6. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
7. Organizatat jofitimprurëse të kontraktuara për ofrimin e shërbimeve
8. Psikologu



Arsimimi



Mbështetja shëndetësore



Mbështetja psiko-sociale



Strehimi



Punësimi dhe formimi profesional



Ndihma ligjore

5.4 Strehimi

Strehimi social nënkupton planifikimin e programeve sociale dhe administrimin e tyre me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe cilësor për familjet dhe individët me të ardhura të ulëta dhe të mesme si dhe familjet në kondita të pafavorizuara, që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale për t'i bërë ballë çmimeve të tregut dhe si rrjedhojë kanë nevojë për strehim dhe ndihmë nga shteti. Programet sociale të strehimit janë të rregulluara nga legjislacioni në fuqi dhe janë të hapura për çdo individ mbi moshën 18 vjeç, duke përmbushur disa kritere të përcaktuara në ligj:

1. nuk kanë banesë në pronësi ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi
2. kanë mbetur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore, prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë, zhvendosje për shkak të investimeve publike/private dhe objekteve që nuk janë pjesë e procesit të legalizimeve, vendimeve formës së prerë të gjykatës,
3. familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje ose banesë që i nënshtrohet planit rregullues për shkak të vjetërsisë së saj
4. përfitojnë edhe shtetasit e huaj, rezident në Shqipëri, që kanë statusin si punëtor emigrant dhe azilkërkues
5. përfitojnë nga programet e strehimit social edhe të miturit nën moshën 18 vjeç në konflikt më ligjin, të liruar, që mbesin të pastrehe sepse me vendim gjykatë nuk mund të jetojnë më familjen.

Në programet sociale përfshihen:

1. Programi i banesave sociale me qira (BSQ)
2. Programi i përmirësimit të banesës ekzistuese deri në ndërtim të ri

3. Programi i banesave me kosto të ulët (BKU)
4. Programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin
5. Programi për krijimin e banesave të përkohshme
6. Programi i banesave të specializuara

5.4.1 Programi i banesave sociale me qira

Programi i banesave me qira nënkupton dhënien me qira të banesave në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social (cdo subject publik/privat përveç njësisë së vetëqeverisjes vendore, që investon në banesa sociale). Në programin e banesave sociale me qira përfshihen: banesa sociale që ndërtohen ose blihen nga bashkia, me qëllim dhënien me qira, banesa ekzistuese në pronësi të pronarit social, objekte të dala jashtë funksionit në pronësi të bashkisë por që mund të janë miratuar për t'u kaluar si fond banesash sociale me qira, që subvencionohen.

Instrument i këtij programi është edhe **Bonusi i qirasë** për individët/familjet, të ardhurat e të cilëve janë të pamjaftueshme për të përballuar pagesën e qerasë sociale ose të tregut. Përparësi në dhënien e Bonusit të qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë: individët me statusin e jetimit, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, invalidët e punës, familjet e policëve të rënë në detyrë, emigrantët e rikthyer, punëtori emigrant, azilkërkuesi, familjet e komunitetit rom/egjiptian, viktimat e dhunës në familje/trafikimit, prindërit ë vetëm me fëmijë në ngarkim, individët e komunitetit LGBTI, të miturit 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në konflikt me ligjin pas kryerjes së dënimit, vajzat nëna pas daljes nga programi i banesave të specializuara, familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private. Subvencioni është në varësi i të ardhurave të familjeve përfituese. Mund të përfitohet deri në 100% nga familjet që përfitojnë nga skema e NE dhe ato që janë në kushtet e përfitimit por që nuk e kanë përfituar si dhe ata që strehohen në banesa sociale me qira.

5.4.2 Programi i Banesave me Kosto të Ulët (BKU)

Përfitojnë nga programi i Banesave me Kosto të Ulët familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës vërtetojnë:

1. Nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsim prone gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit kur prona është humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje/sëmundje e rëndë) ose force madhore

2. Zotërojnë banesë nën normat e strehimit
3. Janë të zhvendosur nga banesat (për vepra publike/prishje për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit)
4. Kur përfituesi është familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga privatizimi ose blerjes në tregun e lirë, sipërfaqe që rezulton nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi me banesë në normat e strehimit duke u llogaritur diferenca mes dyjave

Përfituesit e grantit të menjëhershëm janë familjet të cilat në përbërje të tyre kanë: një person me aftësi të kufizuar, një person që ka statusin e jetimit që në momentin e aplikimit nuk ka mbushur 30 vjeç, kryefamiljari i vetëm më fëmijë në ngarkim nën moshën 18 vjeç, familjet e komunitetit rom/egjiptian. Familjet që përfitojnë banesë më kosto të ulët mund të përfitojnë edhe **subvencion të interesave të kredisë** kur më të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesat e kredisë. Masat e subvencionit dhe procedurat vendosen me VKM.

5.4.3 Programi banesave të specializuara

Banesat e specializuara janë banesa që adresojnë një nevojë specifike strehimi, ku përfshihen banesat për të moshuarit dhe/ose personat më aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, fëmijët që janë pa kujdes prindëror ose që janë marrë në mbrojtje nga shteti dhe që përgatiten të kalojnë në jetën e pavarur, të mituri të moshës 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në konflikt më ligjin pas lirimit, vajzat nëna. Banesat e specializuara për të qenë të tilla duhet të pajisen dhe shoqërohen me infrastrukturën e përshtatshme e të aksesueshme për lehtësimin dhe sigurimin e marrjes së ndihmës së shpejtë mjekësorë dhe shërbimin e punonjësve të specializuar social apo të punonjësve të policisë për të siguruar mbrojtjen fizike dhe parandaluar rrezikimin e jetës të përfituesve të programit të banesave të specializuara.

Banesat e specializuara për të moshuar dhe personat me aftësi të kufizuar jepen në uzufukt me afat sa jetëgjatësia e përfituesve. **Banesat e specializuara për viktimat** e dhunës në familje dhe trafikimit jepen me qira sipas kushteve të përcaktuara më programin e banesës me qira, janë të pajisura më infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë në rast të rrezikut ose emergjencash. **Banesat e specializuara për të miturit** janë të pajisur më shërbimin e kujdestarisë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre për arsim, shëndet, mirërritje, punësim me qëllim riintegrimin në komunitet. Banesat për të rinjtë 18-21 vjeç jepen me qira kur nuk kanë banesë ose kur duhet të jetojnë larg familjes dhe jepen në huamarrje kur të rinjtë nuk janë në marrëdhënie pune derisa të sigurojnë punësim. Banesat për të mitur dhe

të rinjtë ofrojnë shërbimin e psikologut dhe punonjësit social. **Banesat e specializuara për vajzat nëna** sigurojnë sistemimin e këtyre vajzave gjatë dhe pas shtatzënisë deri sa fëmija të bëhet 5 vjeç, kur ato janë të vetme dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar strehim, më pas kalojnë në një program tjetër social që i përgjigjet gjendjes së tyre ekonomike.

5.4.4 Programi i Strehëve të përkohshme

Programi i strehëve të përkohshme adreson zgjidhjen e situatave emergjente për strehimin e qytetarëve në nevojë. Strehët e përkohshme janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që nevojiten për strehimin e përkohshëm të personave për një afat jo më të gjatë se 2 vjet. Me kalimin e këtij afati përfituesve të programit, i lind e drejta për të aplikuar në programet e tjera sociale të strehimit.

Strehët e përkohshme mund të përdoren për strehimin e refugjatëve, personave që zhvendosen nga vendbanimi i tyre për shkak të fatkeqësive natyrore, situatës së emergjencës, investimeve publike që nuk përfitojnë kompensim, emigrant të kthyer që nuk kanë strehim, persona të pastrehë që banojnë në mjedise që nuk kualifikohen si vend për banim. Strehët e përkohshme vendosen në vende të përshtatshme, të pastra dhe të sigurta nga përmbytjet dhe rreziqet e tjera. Minimalisht, pavarësisht kushteve dhe pa diskriminuar duhet të garantohet: ushqim i pijshëm/ushqim, higjienë bazë, veshje të përshtatshme, shërbime mjekësore bazë, burime jetese, arsim për fëmijët dhe ambiente për kujdesin e fëmijëve. Procedura për përfitim të këtij programi fillon më kërkesën me shkrim duke specifikuar situatën në të cilën gjenden dhe plotësimin e deklaratës për vërtetësinë e të dhënave. Në këto raste lista më emrat e personave që përfitojnë nga programi i strehëve të përkohshme paraqitet menjëherë për miratim në Këshillin Bashkiak.

5.4.5 Programi për përshtatjen dhe përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave

Programi nënkupton ndihmën që jepet në formën e granteve konkurruese, njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit me qëllim përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave. Banesat që trajtohen nga ky program deri në ndërtimin e ri janë: banesat e amortizuara që kanë nevojë për ndërhyrje, banesat në rrezik shembjeje, rregullimi i banesave individuale ose strukturave që nuk klasifikohen si banesë, nga vetë familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin. Programi ndihmon familjet në nevojë që banojnë në banesat e sipërpërmendura. Përparësi në përfitimin nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave deri në ndërtimin e ri e kanë:

familjet/individët ku mungojnë shërbimet bazë, të personave me statusin e jetimit, personave me aftësi të kufizuar, familjet e policëve të rënë në detyrë, prindi i vetëm, të moshuarit dhe viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje.

5.4.6 Programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin

Programi Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin bëhet për ndërtimin e banesave sociale dhe përfshin investimet në rrjetin kryesor dhe dytësor të furnizimit të ujit të pijshëm, largimin e ujërave të zeza, rrjetin elektrik dhe telefonik si dhe nxjerrjen e lejes së ndërtimit me projektin e miratuar dhe dokumentacionin e nevojshme. Trualli i pajisur më infrastrukturën e nevojshme, pjesë e zhvillimit të një zone me qëllim strehimin, mund t'i ofrohet pa shpërblim nga shteti për ndërtim edhe familjeve përfituese që marrin përsipër të ndërtojnë banesë mbi të dhe me shpenzimet e tyre. Përparësi në përfitimin e këtij programi e kanë familjet /individë të pastrehë, të cilët në atë zonë e kanë siguruar strehimin më ndërtime të pa legalizuara dhe që nuk mund të legalizohen si dhe në zonat e vjetra industriale, jofunksionale të zëna pa autorizim nga ata.

Aplikimi për përfitimin të programeve sociale bëhet pranë zyrës përkatëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore të vendbanimit (bashki). Aplikanti paraqet kërkesën për përfitim vetëm nga njëri prej programeve sociale dhe përveç rastit të nevojës urgjente, aplikimi bëhet në dy faza. Përzgjedhja e përfituesve nga programet sociale bëhet nëpërmjet sistemit të pikëzimit të hartuar, miratuar dhe publikuar çdo vit nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Aplikimi bëhet nga vetë individi/familja, kujdestari ligjor për personat e vendosur nën kujdestari ligjore, përfaqësuesi i caktuar me vendim gjykate për të miturit nën 18 vjeç, për viktimat e dhunës në familje kërkohet vetëm paraqitja e urdhrin të mbrojtjes ndërkohë që i gjithë dokumentacioni i nevojshëm sigurohet nga njësia e bashkisë përgjegjëse për strehim, pas miratimit të individit viktimë e dhunës.

Kriteret kryesore për të përfituar nga programet e strehimit social janë:

1. Të jetë banor i bashkisë ku aplikon
2. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur parashikohet në ligjin për strehimin social
3. Të mos ketë banesë në pronësi ose të zotërojë një sipërfaqe banimi nën normat e strehimit sipas legjislacionit në fuqi
4. Të ketë të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e strehimit sipas legjislacionit në fuqi.

Në fazën e parë të aplikimit:

1. Fotokopje e kartës së identitetit
2. Plotësimi i formularit tip të miratuar nga këshilli i bashkisë sipas modelit të përcaktuar në VKM. 384/2019 më të dhënat e kërkuarit.

Në fazën e dytë përfshihen vetëm ata individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit social dhe paraqitet dokumentacioni që vërteton deklaratimet e bëra në fazën e parë. Dokumentacioni që paraqitet në këtë fazë është:

Për të dhënat personale:

1. Certifikatë e lindjes dhe certifikatë e gjendjes familjare
2. Vërtetim vendbanimi për familjet e ardhura nga zona të tjera të vendit.

Për vërtetimin e kushteve të strehimit:

1. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes
2. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo një anëtar i saj kur banesa është nën normat e strehimit
3. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të origjinës se nuk zotërojnë asnjë pronë që mund të përdoret për strehim (kur kanë ndryshuar vendbanim)
4. Akt verifikimi i Bashkisë për:
 - Banesat në rrezik shembjeje
 - Kur familja është e pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore
 - Banesat që prishën ose përjashtohen nga procesi i legalizimit
 - Kur familja jeton në banesë/strukturë që nuk klasifikohet si banesë
5. Vendimi i Gjykatës për familjet që humbin banesën për shkak të këtij vendimi.

Për vërtetimin e kushteve familjare:

1. Certifikatë familjare

2. Vendim i Gjykatës që lë në ngarkim fëmijën/ët për çiftet e divorcuara shoqëruar me vërtetimin për masën e pensionit që merr fëmija.

Për vërtetimin e kushteve sociale:

1. Vërtetim komisioni mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për PAK
2. Për jetimet, vërtetimin e institucionit ku ka qenë strehuar, librezën e statusit të jetimit
3. Dokument që vërteton që ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish pronë e subjekteve të shpronësuara
4. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për individët që kanë status emigrant, punëtor emigrant, azilkërkues
5. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë
6. Për viktimat e dhunës në familje, dokument nga zyrat përkatëse:
 - Urdhri i mbrojtjes i lëshuar nga Gjykata
 - Vërtetim nga qendra kombëtare e shërbimit të përkujdesit shoqëror
 - Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendra sociale e shërbimit të përkujdesit shoqëror pranë njësisë bashkisë
7. Vetëdeklarim kur individ/familja i përket pakicës rom/egjiptian
8. Dokument nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin
9. Vetëdeklarim nëse individ i përket grupimit LGBTI
10. Dokumenti zyrtar i celebrimit të martesës për efekt llogaritjen e moshës për çiftet e reja
11. Vërtetim me certifikatë familjarë nëse individ i pëlqen kategorisë vajzë nënë.

Për vërtetimin e kushteve ekonomike:

1. Vërtetim i të ardhurave neto të shoqëruar me vërtetimin e drejtorisë së tatimeve për derdhjen e kontributeve, vërtetim punësimi nga punëdhënësi e të gjithë personave në marrëdhënie pune
2. Vërtetim i drejtorisë së tatimeve për derdhjen e kontributeve, kur janë të vetëpunësuar
3. Vërtetim nga zyra rajonale e punësimit për personat e përfshirë në pagesën e papunësisë
4. Vërtetim nga drejtorja e tatimeve për personat në pension

Përveç këtij dokumentacioni bazë të parashikuar në legjislacionin në fuqi, bashkia mund të kërkojë dokumente shtesë të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak me qëllim plotësimin e dosjes së përfituesve të programeve të strehimit social.

Baza ligjore e strehimit social: Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr. 384/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 301/2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesa më kosto të ulët”, VKM nr. 361/2019 “Për përcaktimin të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, VKM nr. 453/2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë BKU, me kredi të lehtësuar nga shteti”, VKM nr. 454/2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, VKM nr. 459/2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencione të qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr. 361/2019 “Për përcaktimin e zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, VKM nr. 405/2016 “Për miratimin e strategjisë së strehimit 2016-2025”.

Institucionet përgjegjëse:

1. Ministria e Financave, drejtorja përkatëse për strehimin
2. Ministria e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, drejtorja përkatëse për çështjet sociale
3. Ministria e Brendshme, drejtorja përkatëse për çështjet vendore
4. Njësia e vetëqeverisjes vendore, zyra përkatëse e strehimit
5. Këshilli i njëjësive të vetëqeverisjes vendore
6. Enti Kombëtar i Banesave



Arsimimi



Mbështetja shëndetësore



Mbështetja psiko-sociale



Strehimi



Punësimi dhe formimi profesional



Ndihma ligjore

5.5 Punësimi dhe formimi profesional

5.5.1 Programet e nxitjes së punësimit

Programet e nxitjes të punësimit janë një instrument i rëndësishëm që ka si qëllim uljen e papunësisë nëpërmjet mbështetjes (subvencione) ndaj bizneseve për krijimin e vendeve të reja dhe të qëndrueshme të punës. Këto programme zbatohen nëpërmjet zyrave rajonale të punësimit në bashkëpunim me qendrat e formimit profesional. Programet parashikojnë edhe ofrimin e trajnimeve profesionale, me qëllim rritjen e aftësive të të papunëve dhe rritjen e mundësive të punëdhënësve të përzgjedhin një forcë punëtorë të kualifikuar.

Programet e nxitjes së punësimit kanë në qendër të vëmendjes punëkërkuarit e papunë në vështirësi siç janë punëkërkuarit afatgjatë, femrat nga grupe të veçanta, personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, personave më aftësi të kufizuar apo të rinjve me statusin e jetimit, pjesëtarët e familjeve më numër të madh pjesëtarësh, personat që jetojnë në zonat rurale, emigrantët e rikthyer etj. Prioritet i jepet grupmoshave 15-29 vjeç pasi papunësia e identifikuar tek kjo grup moshë është dy herë më e lartë se papunësia mesatare.

Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësinë, nëpërmjet strukturave rajonale dhe vendore, është institucioni i cili rregullon dhe kontrollon zbatimin e shërbimeve të punësimit dhe programet aktive (programet e nxitjes së punësimit) dhe pasive (pagesa e papunësisë) të tregut të punës që synojnë nxitjen e punësimit të punëkërkuarëve të papunë, integrimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të veçanta të dizavantazhuar në tregun e punës. Punëkërkuarët e papunë i regjistruar merr, përveç shërbimeve të punësimit edhe formim profesional falas në qendrat publike të formimit profesional. Aplikimi i regjistrimit në zyrën e punësimit është shërbim pa pagesë.

Përfituesit e shërbimeve dhe programeve të punësimit janë:

1. Çdo punëkërkuës dhe punëdhënës i regjistruar në zyrën rajonale/ vendore të vendbanimit
2. Shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi që hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin shqiptar, për qëllime punësimi
3. Shtetasit e huaj që kanë statusin e refugjatit dhe azilkërkuësit.

Për t'u regjistruar si punëkërkuës i papunë në zyrën e punës:

1. Dokument identifikimi
2. Librezë pune (nëse ka).

Zyra rajonale/lokale e punësimit siguron dhe ofron informacion mbi kërkesën e ofertën në tregu e punës. Shërbimet e ofruara përfshijnë:

1. Tregun kombëtar, rajonal dhe lokal të punës
2. Shërbime punësimi dhe programe për punëkërkuësin dhe punëdhënësin
3. Mundësitë e punësimit
4. Ofertat arsimore e kualifikuese të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional
5. Orientim dhe karrierë profesionale
6. Të drejtën e përfitimit nga programet e mbështetjes, të ardhurat dhe procedurat e aplikimit
7. Legjislacionin e punës.

Programet e nxitjes së punësimit janë:

1. Programi i punësimit
2. Formimi nëpërmjet punës
3. Praktika profesionale
4. Programi i vetëpunësimit
5. Programi i punëve publikë në komunitet
6. Programi i punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e Covid-19

Kriteret për të aplikuar dhe përfituar nga programet e nxitje së punësimit si punëkërkues:

1. Punëkërkues të papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 3 muaj në zyrën e punës
2. Punëkërkuesi që ka marrë të gjitha shërbimet e nevojshme të punësimit nga punonjësi i shërbimeve të punësimit
3. Punëkërkuesi mund të marrë pjesë vetëm 1 herë në një program për një periudhë 5-vjeçare
4. Punëkërkuesi, pjesëmarrës në program, nuk mund të zëvendësohet.

Kriteret për të aplikuar dhe përfituar nga programet e nxitje së punësimit si punëdhënës:

1. Duhet të jetë shoqëri tregtare e regjistruar për jo më pak se 6 muaj
2. Të ketë paguar taksat dhe të gjitha sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, të mos ketë detyrime ndaj organeve tatimore
3. Të ofrojë punë më kohë të plotë (40 orë në javë) dhe pagë jo më pak se paga minimale e përcaktuar në Kodin e Punës
4. Punëdhënës, me 5 punonjës a më shumë, ka të drejtë të aplikojë në më shumë se një program për një numër punëkërkuesish jo më të madh se 20 % të fuqisë aktuale por jo më shumë se 21 pjesëmarrës
5. Punëdhënësi me më pak se 5 punonjës mund të aplikojë për maksimumi 2 pjesëmarrës.

Programi i punësimit

Programi i punësimit është një program 1 vjeçar punësimi, ku nevojat e punëkërkuesit përshtaten me kushtet e punëdhënësit dhe paga përcaktohet në kontratën e punës në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg. Programi subvencionon:

1. kostot për kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura sipas pagës minimale, gjatë gjithë kohëzgjatjes së punësimit
2. financimi i pagës në shumën 100% i pagës minimale në shkallë vendi:
 - për 4 muaj për të gjithë pjesëmarrësit në program
 - për 6 muaj për pjesëmarrësit që janë viktimat e trafikimit, të dhunës në familje apo me bazë gjinore, romë/egjiptian
 - për 12 muaj për pjesëmarrësit që janë persona me aftësi të kufizuar.

Punëkërkues të papunë që kanë të drejtë përfitimi nga programi i punësimit:

1. të rinjtë nën moshën 29 vjeç
2. punëkërkues të papunë afatgjatë
3. punëkërkues mbi moshën 45 vjeç
4. punëkërkues të papunë të pakualifikuar
5. punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se 2 vjet nga emigracioni
6. punëkërkues për përfiton nga skema e ndihmës ekonomike, duke trajtuar më prioritet përfituesit që parashikohet të dalin nga skema e përfitimit të NE
7. punëkërkues që merr pagesë papunësie prej më shumë se 3 muaj
8. punëkërkues që është person me aftësi të kufizuar
9. punëkërkues, viktimë e trafikimit/dhunës në familje/dhunës më bazë gjinore
10. punëkërkues i komunitetit rom/egjiptian
11. persona që kanë përfunduar kurset profesionale ose programet e formimit nëpërmjet punës dhe janë ende të papunë deri 24 muaj pas diplomimit.

Programi i formimit nëpërmjet punës

Ky program ka si qëllim trajnimin në punë të punëkërkuesve të papunë dhe të pakualifikuar sipas nevojave të punës të kërkuar të përshtatur me nevojat e punëdhënësit. Kohëzgjatje e këtij programi është për një periudhë 4-mujore subvencionimi për të gjitha profesionet. Programi subvencionon edhe 8 muaj të tjerë kur punëdhënësi nënshkruan një kontratë punësimi me punëkërkuesin e papunë përfitues. Plani i individuale i trajnimit hartohet nga punëdhënësi, i cili cakton edhe një trajner për çdo grup përfituesish (nga 1-7 vetë përfitues). Programi subvencionon:

- kostot për kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura sipas pagës minimale, gjatë gjithë kohëzgjatjes së formimit
- financimi i pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi
- kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për 8 muajt e ardhshëm në rast të lidhjes së kontratës së punës pas përfundimit të programit
- pagesën për trajnuesin në vlerën 2 mijë lek për çdo përfitues.

Programi i praktikave profesionale

Ky program ka si qëllim të garantojë futjen e shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë tjetër të ngjashme më atë për të cilën ka studiuar i diplomuari. Qëllimi i programit është pajisja me një profesion të punëkërkuesve të papunë të regjistruar dhe punësimi real i tyre si dhe mbështetja financiare e bizneseve për të hapur vende punë. Në përfundim të periudhë së formimi, punëdhënësi detyrohet të punësojnë jo më pak se 50% të të trajnuarve, me kontratë pune jo më të shkurtër se 6 muaj. Kohëzgjatja e subvencionit për këtë program punësimi është për një periudhë 6 mujore për punëkërkuesit e papunë të sapodiplomuar deri në 24 muaj pas diplomimit. Programi subvencionon:

- kontributet për sigurimin nga aksidentet në punë
- financim i pagës deri në shumën 50% i pagës minimale në shkallë vendi.

Përveç subvencionimit të kostove të mbuluara nga përfitimi i programeve të mësipërme janë parashikuar edhe disa përfitime shtesë për përfituesit që janë jetimë, prindër të vetëm më fëmijë nën moshën 6 vjeç, prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar, viktimat e trafikimit/dhunës në familje/dhunës me bazë gjinore dhe përfitues të ndihmës ekonomike:

- bonus për shpenzime të transportit që kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës (1600 lekë në muaj)
- bonus për ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim (3000 lekë në muaj)
- përshtatjen e ambientit të punës për personat me aftësi të kufizuar (deri në 200 mijë lekë për punëdhënësin).

Programi i vetëpunësimit

Ky program është një program që ka një periudhë kohore 1-vjeçare dhe synon nxitjen e sipërmarrjes tek punëkërkuesit e papunë, të regjistruar në zyrën e punës, të cilët kanë një ide biznesi. Programi i vetëpunësimit zhvillohet në formën e trajnimeve për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grantit për përfituesit. Të gjithë personat e përfshirë në program do të përfitojnë:

1. trajnime për zhvillimin e planit të biznesit dhe njohjen e koncepteve bazë të lidhur me vetëpunësimin
2. mbështetje financiare për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve deri në vlerën 500 mijë lekë

3. shpenzimet për vlerësimin e planit të e biznesit deri në vlerën 3 mijë lekë për çdo plan biznesi

Në momentin e përfitimit të grantit nga programi i vetëpunësimit:

- të gjitha shpenzimet që do të mbulohen nga financimi duhet të jenë të pasqyruara në planin e biznesit por nuk duhet të përfshijnë: shpenzimet për qiranë; pagat dhe kontributet; blerjen e pasurive të paluajtshme
- shpenzimet e kryera para lidhjes së kontratës së financimit nuk merren parasysh nga financimi
- shpenzimet e grantit realizohen vetëm përmes transaksioneve bankare apo faturave me TVSH. Blerjet me para në dorë janë të papranueshme.

Programi i vetëpunësimit zbatohet në rajonin e Tiranës, Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës.

Programi i punëve publike në komunitet

Ky program ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe i drejtohet punëkërkuesve të papunë afatgjatë nëpërmjet ofrimit të mundësive për trajnim dhe punësim me kohë të pjesshëm në aktivitete më fokus shërbimet ndaj komunitetit. Fushat e veprimtarisë së programit të punëve publike në komunitet përfshijnë:

1. shërbimet e kujdesit për fëmijët
2. shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social
3. shërbime të rehabilitimit të ish përdoruesve të substancave narkotike
4. punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin
5. shërbime këshillimi dhe informacioni
6. shërbime rinore
7. sport
8. art, kulturë, turizëm.

Kriteret e aplikimit:

1. Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 12 muaj në zyrën e punës, të moshës mbi 25 vjeç, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme nga punonjësi i zyrës së punësimit

2. Punëkërkuksi merr pjesë në këtë program vetëm 1 herë brenda një periudhe 5 vjeçare
3. Punëdhënësit e regjistruar në zyrën e punës me të drejtë përfitimi janë:
 - organizatat jofitimprurëse
 - organizata të shoqërisë civile
 - biznese sociale/ sipërmarrje sociale/ndërmarrje sociale
 - institucione publike të cilat zbatojnë projekte me interes publik, në nivel vendor dhe në favor të komunitetit, të cilat kanë kapacitetet dhe eksperiencën e nevojshme për zbatimin e këtyre projekteve
4. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë për maksimumi 2 grupe më një numër jo më të madh se 7 punëkërkuks për secilin grup
5. Punëdhënësi ka për detyrë të punësojë një mbikëqyrës i cili është përgjegjës për zhvillimin e planit individual të trajnimit, për çdo grup përfituesish.

Punëkërkuksi i papunë afatgjatë, në momentin e përzgjedhjes si përfitues nga programi i punëve publike në komunitet, përfiton:

- financim i pagës deri në shumën 50% i pagës minimale në shkallë vendi
- kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura sipas pagës minimale, gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit
- bonus për trajnimin e punëkërkuksve të papunë deri në 20 mijë lekë, kur trajnimet nuk ofrohen nga institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional
- bonus shtesë për shpenzime transporti, kopsht/çerdhe dhe përshtatja e ambientit të punës do të ketë për kategoritë vulnerabël: jetimë, prindër të vetëm më fëmijë nën moshën 6 vjeç, prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar, viktimat e trafikimit/dhunës në familje/dhunës me bazë gjinore dhe përfitues të ndihmës ekonomike.

Punëdhënësi përfitues nga programi i punëve publike në komunitet përfiton një grant për financimin e shpenzimeve, duke përfshirë:

- mbulimin e 50% deri në 100% të pagës së mbikëqyrësit, në varësi të numrit të pjesëmarrësve përfitues
- kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura sipas pagës minimale, gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit

- shumën deri në 10 mijë lekë për çdo përfitues, për shpenzimet në material të nevojshme për zbatimin e programit të punësimit në komunitet
- granti disbursohet në këste, pas verifikimeve të rastit.

Për përfitimin nga programet e nxitje së punësimit nga punëkërkues të papunë, aplikimi bëhet pranë strukturës përkatëse vendore të punësimit ose në mënyrë elektronike. Dokumentacioni që duhet paraqitur:

1. kopje e dokumentit të identifikimit
2. formulari i aplikimit, i plotësuar në të gjitha pjesët e tij
3. vërtetim nga drejtoria vendore e tatimeve që personi nuk ka detyrime tatimore
4. afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga të gjithë punëkërkuesit e papunë, është 30 ditë kalendarike nga njoftimi i programit në buletinin e njoftimeve publike të APP-së.

Për përfitimin nga programet e nxitjes së punësimit për punëdhënës, aplikimi bëhet online nëpërmjet portalit e-Albania duke ndjekur hapat e kërkuar:

1. identifikimi si biznes në portal
2. aplikimi për regjistrim në programet e nxitjes së punësimit
3. përzgjedhja e njërit prej programeve
4. plotësimi i formularit
5. ngarkimi i dokumentacionit të kërkuar: Dokument justifikues për rastet e detyrimeve tatimore.

Formimi Profesional

Punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit orientohen gjithmonë e më tepër drejt kurseve profesionale për t'u kualifikuar në aftësitë e tyre. Programet e formimit profesional ofrohen nga zyrat e punësimit dhe qendrat publike të formimit profesional. Në qendrat publike të formimit profesional ofrohen kurse në nivel kombëtar dhe kurse në nivel qendre.

Kurset në nivel kombëtar janë kurse të unifikuara për të gjitha qendrat e formimit dhe ofrohen sipas programeve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve. Zakonisht përbëjnë kualifikime profesionale afatgjata, por me kohëzgjatje jo me shumë se 2 vjet. Kurset në nivel qendre janë kurse specifike që ofrohen nga qendra rajonale dhe lokale në bashkëpunim me bizneset lokale. Zakonisht janë kurse afatshkurtra dhe

shërbejnë për kualifikime të shkurtra, për procese të ndryshme teknologjike. Kurset e kualifikimit profesional hartohen dhe zbatohen nga qendra publike e formimit profesional në bashkëpunim me zyrën e punësimit, duke u bazuar në kërkesën e punëkërkuësve të papunë për formim dhe bizneseve për punonjës të kualifikuar.

Për disa kategori, siç janë të papunët e regjistruar dhe grupet vulnerabël kurset e formimit profesional në QFP ofrohen falas. Këto qendra publike ofrojnë edhe kurse suplementare të gjuhës së huaj dhe përdorimit të kompjuterit.

Përfituesit e programeve të formimit profesional të ofruara nga qendrat e formimit profesional:

1. Punëkërkuës të papunë të regjistruar në zyrën e punësimit, që janë pa një profesion ose që duan të ndryshojnë profesion
2. Të punësuar dhe nxënës shkolle që duan të plotësojnë njohuritë e tyre në një fushë të caktuar
3. Persona të grupeve në nevojë që duan të fitojnë një profesion (pjesëtarët e komunitetit rom/egjiptian, vajza/gra të trafikuar/dhunuara, status jetim, PAK, të burgosur, emigrantë të kthyer)
4. Shtetas të huaj me lejë qëndrimi që duan të formohen profesionalisht.

Dokumentacioni i nevojshëm për të aplikuar në programet e formimit profesional:

1. Fotokopje e dokumentit të identifikimit
2. Fotokopje e diplomës/dëftesës së shkollës
3. Mandatpagesa (nëse nuk është punëkërkuës i papunë)
4. Fletën e drejtimit për formim profesional (nëse është punëkërkuës i papunë)
5. Dokumentacion që vërteton statusi për personat e grupeve në nevojë.

Aplikimi për kurse të formimit profesional kur, përfituesi është i punësuar, bëhet edhe nëpërmjet portalit e-Albania duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimi si qytetar në portal
2. Zgjedhja e “Aplikim për formim profesional”
3. Plotësimi i formularit dhe dërgimi i aplikimit

4. Në momentin e pranimit të kërkesës, pranë drejtorisë rajonale të formimit profesional dorëzohen dokumentet e mësipërm.

Kuadri ligjor që rregullon kuadrin e programeve të nxitjes së punësimit me qëllim uljen e papunësisë: Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Ligji nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional”, Ligji nr. 761/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 554/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit”, VKM nr. 17/2020 “Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, VKM nr. 348/2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”, VKM nr. 535/2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”, VKM nr. 608/2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e Covid-19”.

Institucionet përgjegjëse:

1. Ministria e Financave
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit
3. Drejtoria rajonale dhe zyra vendore e punësimit
4. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional
5. Qendrat publike të formimit profesional.

Fondi i sipërmarrjes së Grave dhe Fondi fillestar

Përsa i përket fuqizimit të grave sipërmarrëse, legjislacioni kombëtar në fuqi nuk është specifik për këtë kategori, ashtu si edhe për fondin fillestar. Fuqizimi i grave sipërmarrëse përfshihet në projekte të ndryshme nga Bashki specifike apo nga organizata jofitimprurëse apo të shoqërisë civile. Një nga projektet në këtë drejtim është ai i Bashkisë Tiranë “Fondi për gratë sipërmarrëse” i financuar nga vetë bashkia, nismë e Aleancës së Grave të Këshillit të Bashkisë. Për aplikimet duhet referuar Bashkisë Tiranë.

Bizneset sociale

Sipas përkufizimit të Bashkimit Evropian, bizneset sociale janë ato ndërmarrje që kanë si qëllim primar ndikimin social, më shumë sesa gjenerimin e fitimeve të ndërmarrjes. Legjislacioni në fuqi për biznesin social rregullon e

veprimtarinë e këtyre bizneseve me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël nëpërmjet:

1. punësimin në përputhje me dinjitetin njerëzor
2. mundësi të punësimi për ato persona, të cilëve moshë, shëndeti, gjendja familjare nuk u lejon disponueshmëri aktive në tregun e punës
3. ofrimin të mallrave dhe shërbimeve për individët me nevoja të veçanta apo pjesëmarrjen e grave në tregun e punës
4. integritin social dhe ekonomik të grupeve në nevojë.

Ndërmarrjet sociale janë organizata jofitimprurëse që marrin status si “Ndërmarrje sociale” dhe kontribuojnë në mbështetjen e target grupeve të pafavorizuara nëpërmjet punësimin e tyre dhe ofrimin të shërbimeve. Në grupet e pafavorizuara hyjnë personat që jetojnë në një varfëri ekstreme, janë punëkërkuar pa punë afatgjatë, persona të diskriminuar, të proceduar penalisht apo në varësi të substancave narkotike, alkoolit, personat e shpërngulur.

Për të fituar statusin e ndërmarrjes sociale, një nga kriteret është se 30% e punonjësve duhet të vijnë nga grupet e pafavorizuara (lista përcaktohet me VKM) dhe të paktën 20% i të ardhurave, pas vitit të dytë, dhe 30% pas vitit të tretë duhet të realizohen për shërbime sociale, ndërmjetësim për punësim, punësimin e të rinjve, mbrojtje dhe promovim i shëndetit, shërbime në arsim, mbrojtje mjedisore etj. Për ndërmarrjet sociale është parashikuar edhe Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale që subvencionon ndërmarrjet që paraqesin një plan biznesi:

1. veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale (investime në makineri dhe pajisje, kualifikime dhe trajnime për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të grupeve të pafavorizuara, mbulim deri në 50% të pagës minimale të punonjësve të grupeve të pafavorizuara)
2. vende të reja pune të krijuara për punësimin e individëve nga grupet e favorizuara (ndërmarrje që paraqesin propozime që reflektojnë rritjen e të punësuarave nga grupet e pafavorizuara)
3. sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara (deri në 100% të sigurimeve në rastet kur kohëzgjatja e kontratës të punës është jo më pak se 2 vite).

Ndërmarrjet sociale që aplikojnë për ndonjë nga format e subvencionit, duhet që së bashku me kërkesën për projekt-propozim, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. vendimin e gjykatës për regjistrimin si organizatë jofitimprurëse
2. NIPT
3. vërtetim për shlyerjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore
4. numrin e llogarisë bankare
5. vërtetim i shlyerjes së detyrimeve tatimore nga zyra e tatimeve ku organizata ushtron aktivitetin
6. numrin e të punësuarve
7. llojin e veprimtarisë që kryen
8. nivelin e pagës së dhënë për çdo person
9. akte të inspektimit, nëse ka
10. forma të tjera të mbështetjes të siguruar nga shteti.

Baza ligjore: Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 789/2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”, VKM. Nr. 56/2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”, Urdhër nr. 636/2018 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të ndërmarrjeve sociale”.

Institucionet përgjegjëse:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Ndërmarrja sociale
3. Zyra Rajonale e Tatimeve
4. Zyra Rajonale e Punësimit
5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore



Arsimimi



Mbështetja shëndetësore



Mbështetja psiko-sociale



Strehimi



Punësimi dhe formimi profesional



Ndihma ligjore

5.6 Mbështetja ligjore falas

Ndihma juridike falas është një shërbim që garantohet dhe ofrohet falas nga shteti shqiptar për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe të huaj në territorin e Shqipërisë me qëllim ofrimin e mundësive të barabartë të aksesit në drejtësi. E drejta në ndihmën juridike falas buron nga respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në pajtim me standardet dhe parimet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe instrumentet ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim në Shqipëri. Ky shërbim ofrohet për qytetarët me të ardhura të ulëta, personat e përjashtuar në aspektin social, kategoritë e qytetarëve të marginalizuar dhe për të gjithë ata që për çfarëdo arsye gjenden në pamundësi ekonomike të paguajnë një avokat për të mbrojtur të drejtat e tyre të garantuara nga Kushtetuta dhe e drejta ndërkombëtare. Ndihma juridike falas rregullohet me Ligjin “Për ndihmës juridike të garantuar nga shteti ” qëllimi i të cilit është të garantojnë qasjen në drejtësi dhe mbrojtje të drejtë gjyqësore.

Përfituesit e shërbimit ligjor falas janë:

1. Shtetasit shqiptarë me vendbanim/vendqëndrim në Shqipëri
2. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që qëndrojnë në Shqipëri për një periudhë të përkohshme apo të përhershme dhe ata që e përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare
3. Azilkërkues, personat që kanë statusin e refugjatit apo që janë në proces të dhënies apo heqjes së këtij statusi.

Shërbimi i ndihmës juridike falas përfitohet nga të gjithë shtetasit e lartpërmendur që kanë nevojë për këshillim, orientim apo përfaqësim në gjykatë dhe që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj, specifikisht duhet të jenë në pamundësi ekonomike dhe/ose duhet të bëjnë pjesë në një nga

kategoritë e veçanta që ligji për ndihmës ligjore falas parashikon.

Në kuptimin e ligjit, një person ndodhet në kushtet e pamundësisë ekonomike nëse:

- të ardhurat, në rast se jeton në një familje, në total të të gjithë familjes, të përpjesëtuar për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulta se 50 % e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas ligjit në fuqi
- të ardhurat, në rast se nuk jeton në familje, nëse janë më të ulëta se niveli I pagës minimale mujore të përcaktuar sipas ligjit në fuqi
- të mos ketë në pronësi të tij, pasuri që tejkalojnë vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar sipas ligjit në fuqi.

Përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësisht të ardhurave dhe pasurive të tyre individët që bëjnë pjesë në njërin prej kategorive të veçanta:

- viktimë e dhunës në familje
- viktimë e abuzimit seksual
- viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore
- viktimë e mitur
- i mitur në konflikt me ligjin
- fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore
- fëmijë nën kujdestari që kërkojnë të nisnin një proces gjyqësor pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor apo kundër kujdestarit të tyre ligjor
- person më aftësi të kufizuar dhe të verbrit
- person më problem të shëndetit mendor
- person, përfitues të skemave sociale
- person, të cilit i është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi që përbën diskriminim.

Në ligjin për ndihmën juridike falas janë të përfshirë tre llojet e ndihmës juridike falas deri te të cilat mund të vijë kërkuesi:

1. Ndihma juridike parësore
2. Ndihma juridike dytësore
3. Përrjashtimi nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.

Ndihma juridike parësore është forma e parë e shërbimit ligjor, që ofrohet në

zgjdhjen e mosmarrëveshjeve pa qene e nevojshme t'i drejtohesh gjykatës, dhe konsiston në:

- informimin juridik në lidhje me sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet dhe ushtrimi i tyre
- këshillim dhe udhëzim mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjes
- ndihmë në hartimin dhe përpilimin e formularëve për përfitimin e shërbimit si dhe dokumenteve të nevojshme në procedurën administrative
- këshillim juridik për shfrytëzimin e së drejtës të ndihmës juridike dytësore dhe përpilimin e kërkesës për të ushtruar këtë të drejtë
- mbështetje në të gjitha format e tjera juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Ndihma juridike parësore, për përfituesit e shërbimit, ofrohet nga:

1. qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të ngritura sipas legjislacionit në fuqi, në të cilat operojnë juristë me trajnim të posaçëm
2. klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë
3. organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë
4. online përmes platformës www.juristionline.al.

Për të përfituar nga shërbimi juridik parësor personi përfitues duhet të bëjë kërkesë me gojë ose me shkrim pranë ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore, të lartpërmendur. Në momentin e prezantimit të kërkesës, personi përfitues duhet të plotësojë, me ndihmën e juristëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. formularin e kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore
2. formularin e vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë
3. formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta (nëse bën pjesë në një nga kategoritë e përfituese).

Dokumentacioni shoqërues që përfituesi i shërbimit duhet të këtë është:

1. dokument identifikimi
2. certifikatë familjare

3. vërtetim papunësie
4. vërtetim nëse trajtohet me ndihmë ekonomike
5. vërtetim nëse përfiton KEMP
6. vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme nëse disponon
7. vërtetim page bruto dhe neto nëse është në marrëdhënie pune
8. vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet nga ky institucion (siç mund të jetë pensioni i pleqërisë).

Ndihma juridike dytësore është shërbimi ligjor që ofrohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të realizohet vetëm nëpërmjet gjykatës apo prokurorisë. Kjo ndihmë ofrohet nga avokatë të licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Personi përfitues i shërbimit të ndihmës juridike dytësore, me anë të avokatit falas mund ti drejtohet gjykatës apo prokurorisë për zgjidhjen e çështjeve apo problematikave civile, penale e administrative. Personat që përfitojnë nga kjo formë e ndihmës juridike mund të përfitojnë edhe përjashtim nga:

- pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore (shpenzime për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes)
- parapagimi i tarifës së ekzekutimit të vendimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Për të përfituar nga shërbimi juridik dytësor personi përfitues duhet të drejtohet personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose prokurorisë ku ka vendbanimin përpara ose në fillim të një procesi gjyqësor. Kërkesa, e personit përfitues, për të përfituar nga ky shërbim mund të bëhet edhe nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë noteriale ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të ngushtë.

Në momentin e prezantimit të kërkesës, personi përfitues duhet të plotësojë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. formularin e kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike dytësore
2. formularin e vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë
3. formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta (nëse bën pjesë në një nga kategoritë e përfituesve).

Dokumentacioni shoqëruar që përfituesi i shërbimit duhet të ketë është:

1. dokument identifikimi

2. certifikatë familjare
3. vërtetim papunësie
4. vërtetim nëse trajtohet me ndihmë ekonomike
5. vërtetim nëse përfiton KEMP
6. vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme nëse disponon
7. vërtetim page bruto dhe neto nëse është në marrëdhënie pune
8. vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet nga ky institucion (siç mund të jetë pensioni i pleqërisë).

Kuadri ligjor që rregullon ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike falas: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha konventat ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut në të cilat shtetit shqiptar bën pjesë, Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmës juridike të garantuar nga shteti” si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale e Kodi i Procedurës Administrative, Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, VKM nr. 55/2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e OJF që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, Urdhër nr. 59/ 2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, Urdhër nr. 225/2019 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti” si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi që garantojnë ofrimin e të drejtës për ndihmë juridike falas në Republikën e Shqipërisë.

Institucionet përgjegjëse:

1. Ministria e Drejtësisë
2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
3. Dhoma Kombëtare e Avokatisë
4. Gjykata /Prokuroria
5. Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore
6. Klinikat ligjore
7. OJF-të e autorizuara

